

UNGJILLI PAS LLUKAJT

Krye 1

¹ Passi shumë veta vunë dorë të radhitnjënë rrëfim për ato punë, që me të-plottë janë vërtetuarë ndër ne, ² Si kundrë na i kanë lënë ata, të-cilëtë që ndë kryet të heresë i panë me sy, edhe ubënë shërbëtorë të fjalësë, ³ M'uduk e udhësë edhe mua, që u kam rënë prapa të-gjithave që ndë kryet hollë hollë, të të shkruanj me radhë për **këto**, o i pushtëçim fort Theofil, ⁴ Që të njohç të-vërtetuarët' e atyre punëve që u mësove.

⁵ Ndë ditt të Irodhit, mbretit të Judhesë, ishte një prift, **që j'a thoshin'** emërinë Zahari, prej fëmijës' s'Aviajt; edhe gruaja e ati **ishte** prej të bijavet t'Aaronit, edhe emërinë **j'a quanin'** Elisavetë. ⁶ Edhe që të dy ishinë të-drejtë përpara Perëndisë, dyke ecurë pa të-metë ndër gjithë porosit, e drejtërimet të Zotit. ⁷ Edhe ata s'kishinë djalë, sepse Elisaveta ishte beronjë, edhe të dy ishinë të-shkuarë ndë ditt të tyre.

⁸ Edhe ay tek ishte dyke bërë punët' e priftërisë përpara Perëndisë ndë radhët të fëmijës' së ti, ⁹ Pas zakonit të punës' së priftërisë, i ra shorta të hynjë ndë tempullt të Zotit e të djegë thimjamë. ¹⁰ Edhe gjithë shumica ishte dyke falurë përjashta ndë kohët të të-djegurit të thimjamësë.

¹¹ Edhe i uduk ati një ëngjëll i Zotit dyke ndënjurë mb'anët të-djathtë të therores' së thimjamësë; ¹² Edhe Zaharia kur pa, udroth, edhe frikë ra mbi atë. ¹³ Po ëngjëlli i tha, Mos ufrikëso, Zahari, sepse lutja jote udëgjua, edhe gruaja jote Elisavetë dotë të pjellë djalë, edhe dot'j'a quanç emërinë Joan. ¹⁴ Edhe dotë jetë mbë ty gëzim e gas; edhe shumë **veta** dotë gëzonenë për lindjen' e ati. ¹⁵ Sepse dotë jet' i-math përpara Zotit, edhe ver' e të-pira të-fora nukë dotë pijë, edhe me frymë të-Shënjtëuarë dotë mbushetë që nga barku i s'ëmës' së ti. ¹⁶ Edhe shumë nga të bijt' e Israilit i ka për të kthyerë mbë Zonë Perëndin' e tyre. ¹⁷ Edhe ay dotë vinjë përpara ati me frymë e me fuqi të lliut, për të kthyerë zëmërat' e atërvet mbë bijt, edhe të-pabinduritë ndë urtësit të të-drejtëvet, për të bërë gati Zotit **një** llaus të-ndrequrë.

¹⁸ Edhe Zaharia i tha ëngjëllit; Si dot' e marr vesh këtë **punë**; sepse unë jam plak, edhe gruaja ime e-lashtë ndë ditt të saj. ¹⁹ Edhe ëngjëlli u-përgjeq e i tha, Unë jam Gavriili që rri përpara Perëndisë; edhe udërguashë që të të flas tyj, edhe të t'ap zërin' e-mirë për këto **punë**. ²⁰ Edhe na tek dotë jesh pa gojë e dotë mos munç të flaç gjer mb'atë ditë që dotë bënenë këto; sepse nuk' u zure besë fjalëvet të mia, të-cilatë dotë mbushenë ndë kohët të tyre.

²¹ Edhe llauzi po priste Zaharinë, edhe çuditëshinë për të-mënuarit' e ati ndë tempullt. ²² Edhe kur doli, nukë munte t'u fliste atyre; edhe e kupëtuanë, se kishte parë të-faniturë ndë tempullt; edhe ay u bënte me shënja, edhe mbeti i-shurdhërë.

²³ Edhe si umbushnë ditt' e shërbesës' s'ati, shkoj ndë shtëpit të ti. ²⁴ Edhe pas këtyre ditve Elisaveta, gruaj' e ati, umbars; edhe e fshihte vetëhenë pesë muaj, ²⁵ dyke thënë, Se kështu bëri Zoti mbë mua ndër **këto** dit që hodhi syt' e ti **mbi mua**, që të heqnjë të-përqeshuritë t'im ndër mest të njerësvet.

²⁶ Edhe mbë të-gjashtinë muaj, ëngjëlli Gavriil udërgua prej Perëndisë ndë **një** qytet të Galilesë, që e **kishte** emërinë Nazaret, ²⁷ Te **një** virgjëreshë, që ishte vluarë me **një** burrë, që quhej Josif, prej shtëpis' së Dhavidhit; edhe emër' i virgjëreshësë **ishte** Mariam. ²⁸ Edhe ëngjëlli kur hyri tek ajo, tha, gëzohu, o e-mbushurë me hire; Zoti **është** bashkë me ty; e-bekuarë **je** ti ndë mest të gravet. ²⁹ Edhe ajo, kur pa, utrumbullua për falën' e ati; edhe mendonej ç'dotë jetë vallë

këta të-përshëndoshurë? ³⁰ Edhe ëngjëlli i tha, Mos utrëmp, Mariamë; sepse gjete hir për-anë Perëndisë. ³¹ Edhe na tek dotë mbarsesh ndë bark, edhe dotë pjellç djalë, edhe dot'j'a quanç emërinë Jisu. ³² Ky dotë jet' i-math, edhe Bir i të-Lartit dotë quhetë; edhe Zoti Perëndia dot'i apë ati fron' e Dhavidhit, atit t'ati; ³³ Edhe dotë mbretëronjë ndë shtëpit të Jakovit ndë jetët **të jetëvet**, edhe mbretëria e ati nukë dotë ketë të-mbaruarë.

³⁴ Edhe Mariama i tha ëngjëllit, Qysh dotë jetë këjo **punë**, sepse **unë** burrë s'njoh? ³⁵ Edhe ëngjëlli upërgjeq e i tha, Frym' e-Shënjtëruarë dotë vinjë mbë ty, edhe fuqi' e të-Lartit dotë të hiesonjë; për-andaj edhe ajo **foshnj'** e-shënjtëruarë që len **prej teje** dotë quhetë Bir Perëndie. ³⁶ Edhe na Elisaveta, far' e fisi yt, edhe ajo umbars **me** bir ndë pleqërit të saj, edhe ky muaj është' i-gjashti i asaj që quhetë beronjë. ³⁷ Sepse s'ka punë që të jet' e-pamundurë te Perëndia. ³⁸ Edhe Mariama tha, Na shërbëtoreja e Zotit; ubëftë mbë mua pas fjalësë s'ate.

Edhe ëngjëlli iku prej asaj.

³⁹ Edhe nd'ato dit Mariama ungrit, e vate me nxitim ndë malësit, ndë **një** qytet të Judhësë. ⁴⁰ Edhe hyri ndë shtëpit të Zaharisë, edhe përshëndoshi Elisavetënë. ⁴¹ Edhe posa dëgjoj Elisaveta të-përshëndoshurit' e Marisë, këceu foshnjeja ndë barkt t'asaj; edhe Elisaveta umbush me Frymë të-Shënjtëruarë, ⁴² Edhe thërriti me zë të-math, e tha, E bekuarë je ti ndë mest të gravet, edhe e-bekuarë **është** pem' e barkut t'ënt. ⁴³ Edhe nga më ngjau kjo, të vinj' e ëm' e Zotit t'im tek unë? ⁴⁴ Sepse na posa erdhi zëri i të-përshëndoshurit' t'ënt ndë veshët t'im, këceu foshnjeja me gëzim ndë barkt t'im. ⁴⁵ Edhe lum ajo që besoj, se dotë mbushenë tek ajo ç'janë folurë prej Zotit.

⁴⁶ Edhe Mariama tha,

Shpirti im madhëron Zonë, ⁴⁷ Edhe fryma ime ugëzua mbë Perëndinë shpëtimtarinë t'im; ⁴⁸ Sepse shtyri sytë mbë të-përunjurit të shërbëtore's së ti; sepse na që tashi **e paskëtaj** gjithë brezatë dotë më lumëronjënë; ⁴⁹ Sepse i-Forti bëri **punë** të-mëdha tek unë, edhe i-shënjtëruarë **është** emër' i ati; ⁵⁰ Edhe përdëllim' i ati ështëë breza pas brezash mb'ata që i kanë frikë. ⁵¹ Bëri pushtet me krahun' e ti; përndau madhështorë me mendimn' e zëmërës' s'atyre. ⁵² Rrëzoi fuqitarë prej fronesh, edhe lartësoj **njerës** të-përunjurë. ⁵³ Të-uriturë i mbushi së-mirash, edhe të-pasurë i dërgoj jashtë sbrazëtë. ⁵⁴ I ndihu Israilit shërbëtorit të ti, dyke sjellë ndër mëntt përdëllimn' **e t'i**, ⁵⁵ Sikundrë foli mb'atëritë t'anë, mb'Avraaminë e mbë farën' e ati, për jetën' **e jetësë**.

⁵⁶ Edhe Mariama ndënjji bashkë me atë afëro tre muaj; pastaj ukthye ndë shtëpit të saj.

⁵⁷ Edhe Elisavetës' i umbush koha për të pjellë; edhe polli djalë. ⁵⁸ Edhe fqinjit' e farëfisasit' e asaj dëgjuanë, se Zoti madhëroj përdëllimn' e ti tek ajo; edhe gëzoneshinë bashkë me atë.

⁵⁹ Edhe mbë të-tettënë ditë erdhe, që të rrethpresënë djalënë, edhe e quaninë Zahari, mb'emërit të t'et. ⁶⁰ Po e ëma upërgjeq e tha, Jo, po dotë quhetë Joan. ⁶¹ Edhe **ata** i than' asaj, Se s'ka ndonjë ndë fist t'ënt që të quhetë me këtë emërë. ⁶² Edhe bënëinë me shënja t'et t'ati, ç'emërë donte t'i epetë ati. ⁶³ Edhe ay kërkoi një dërrasë të-shkruari, edhe shkroj, dyke thënë, Joan është' emër' i ati. Edhe të-gjith' uçuditnë, ⁶⁴ Edhe për-një-here u hap goj' e ati edhe gjuh' e ati; edhe fliste dyke bekuarë Perëndinë.

⁶⁵ Edhe ra frikë mbë gjith' ata që rrininë rrotull' atyre. Edhe të-gjitha këto fjalë fliteshinë ndëpër gjithë malësit të Judhësë. ⁶⁶ Edhe gjith' ata që i dëgjuanë i vunë **këto** ndë zëmërat të tyre, dyke thënë, Vallë ç'dotë jetë ky djalë? Edhe dor' e Zotit ishte bashkë me atë.

⁶⁷ Edhe Zaharia i ati umbush me Frymë të-Shënjtëruarë; edhe profitepsi, dyke thënë,

⁶⁸ I-bekuarë qoftë Zoti Perëndia i Israilit, sepse erdhi edhe bëri çpërblim mbë llausn' e ti; ⁶⁹ Edhe ngriti bri shpëtimi mbë ne ndë shtëpit të Dhavidhit shërbëtorit të ti, ⁷⁰ Sikundrë foli me anë të gojës' së shënjtëruarëvet profitetvet të ti prej jete, ⁷¹ Shpëtim prej armiqvet t'anë edhe prej dorës' së gjith' atyreve që na kanë mëri; ⁷² Për të mbushurë përdëllimn' e **ti** mb'atëritë t'anë, edhe për të përmendurë dhjatën' e ti të-shënjtëruarë; ⁷³ Pas besë që i ubetua Avraamit atit t'ënë, se dotë na apë ⁷⁴ të shpëtojmë prej dorës' s'armiqvet t'anë, edhe t'i shërbejmë ati pa frikë, ⁷⁵ Me shënjtëri e me drejtëri përpara ati gjithë ditt' (e jetësë s'onë).

⁷⁶ Edhe ti, o djalë, profiti i të-Lartit dotë quhesh; sepse dotë shkonjç përpara faqes' së Zotit, për të bërë gati udhët' e ati, ⁷⁷ Për të dhënë mënt shpëtimi llauzit t'ati, me anë të ndjesës' së fajevet, ⁷⁸ Për përdëllimn' e-thellë të Perëndisë t'ënë, me të-cilinë na erdhi agjim prej së-larti, ⁷⁹ për të ndritur' ata që rrinë nd'errësirë e ndë hie vdekjeje, që të bënë këmbëtë t'ona t'ecëjnë drejtë nd'udhë paqtimi.

⁸⁰ Edhe çuni rritej e forconej ndë frymë, edhe ishte ndë shkretëtirët gjer mb'atë ditë që dotë dëftehej te Israili.

Krye 2

¹ Edhe nd'ato dit doli urdhër prej Qesarit August të shkruhenë gjithë bota. ² Këta të-shkruarë ubë për të-parënë **herë**, kur ishte Qyrini qivernitar i Syrisë. ³ Edhe vininë të-gjithë të shkruheshinë, sicili ndë qytett të ti. ⁴ Hipi edhe Josifi prej Galilesë, prej qytetit Nazaret, ndë Judhet, ndë qytett të Davidhit, që quhetë Vithleem, (Sepse ay ishte prej shtëpis' e prej atëris' së Davidhit), ⁵ Që të shkruhetë bashkë me Mariamënë, që ishte vluarë me atë për grua, e-cila ishte me barrë. ⁶ Edhe ata tek ishin' atje, asaj i umbushnë dittë që të pjellë; ⁷ Edhe polli birr' e saj të-parëllindurinë, edhe e pshtolli ndë shpërgënj, edhe e vuri ndë grasht, sepse nukë kishte vënt për ata atje ku kishinë rënë.

⁸ Edhe nd'atë vënt ndëpër arat ishinë **ca** barinj, dyke ruajturë me radhë natënë tufën' e tyre. ⁹ Edhe javoka një ëngjëll i Zotit erdhi mb'ata, edhe lavdi Zoti ndriti rrotull' atyre, edhe ufrikësuanë frikë të-madhe. ¹⁰ Edhe ëngjëlli u tha atyre, Mos frikësohi, sepse na tek po u ap juve zë të-mirë për një gëzim të math, që dotë jetë mbë gjithë llauzinë; ¹¹ Sepse sot u lindi juve ndë qytett të Dhavidhit një shpëtimtar, i-cili është Zoti Krisht. ¹² Edhe këjo **dotë jetë** shënja ndër ju, Dotë gjeni një foshnjë pshtjellë ndë shpërgënj, dergjurë ndë grasht.

¹³ Edhe papandehuraj bashkë me ëngjëllinë uduk një shumicë ushtërie qiellore, dyke lavduruarë Perëndinë, e dyke thënë, ¹⁴ Lavdi mbë Perëndinë **që është** mbë të-lartat, edhe paqtim mbi dhe, pëlqim ndë njerëzit.

¹⁵ Edhe ëngjëjtë si iknë prej atyreve ndë qiellit, njerëzitë, barinjtë i thanë njeri tjetërit, Letë vemi tani ndë Vithleem, e të shohëm këtë punë që është bërë, të-cilënë Zoti na e dëfteu. ¹⁶ Edhe erdhë me vrap, e gjetnë Mariamën' edhe Josifnë edhe foshnjën dërgjurë ndë grasht. ¹⁷ Edhe si panë, dëftynë për fjalënë që ufol mb'ata për këtë djalë.

¹⁸ Edhe gjith' ata që dëgjuanë uçuditnë për ato që ufolnë barinjtë. ¹⁹ Edhe Mariama i ruante me vetëhe gjithë këto fjalë, dyke menduarë **për ato** ndë zëmëret të saj. ²⁰ Edhe barinjtë u kthyenë dyke lavdëruarë e dyke nderuarë Perëndinë për gjith' ato që dëgjuan' e panë, sikundrë ufol mb'ata.

²¹ Edhe kur umbushnë të tetë dittë për të rrethrerë djalënë, emër' i ati uquajt Jisu, që ishte quajturë prej ëngjëllit para se të zihej ndë barkt.

²² Edhe kur umbushnë ditt e të-pastruarit t'asaj, pas nomit të Moisiut, e prunë ndë Jerusalem, që t'e nxirninë përpara Zotit, ²³ Sikundrë është shkruarë ndë nomt

të Zotit, “Se çdo mashkullë që hap shtrat **barku**, shënjt te Zoti dotë quhetë;”

²⁴ Edhe që të bininë kurban, sikundrë është thënë ndë nomt të Zotit, “Një par turtujsh a dy zoq pëllumbash.”

²⁵ Edhe na tek ishte ndë Jerusolim një njeri, që **e kishte** emërinë Simeon; edhe ky njeri ishte i-drejtë edhe me frikë Perëndie, dyke priturë ngushullimin’ e Israilit. ²⁶ Edhe ish sbuluarë tek ay prej Frymës’ së-Shënjtëuarë, se nukë dotë shihte vdekje, para se të shihte Krishtin’ e Zotit. ²⁷ Edhe erdhi me anë të Frymës’ së-Shënjtëuarë ndë hieroret; edhe prindëritë kur prunë brënda djalënë Jisu, që të bëninë për atë pas zakonit të nomit, ²⁸ Ay e mori ndër duart të ti, edhe bekoj Perëndinë, e tha,

²⁹ Tashi, o Zotëri, lëshon shërbëtorinë t’ënt, pas fjalës s’ate, me paqtim; ³⁰ Sepse panë syt’ e mi shpëtimnë t’ënt, ³¹ Që bëre gati përpara sysh të gjithë lauazëvet, ³² Dritë për të ndriturit’ e kombevet, edhe lavdi për llauzinë t’ënt Israil.

³³ Edhe Josifi edh’ e ëm’ e ati po çuditëshinë për ato që flitëshinë për atë.

³⁴ Edhe Simeoni i bekoj ata, edhe i tha Mariamësë, s’ëmës’ s’ati, Na ky tek është vënë për të-rënit’ e për të-ngriturit’ e shumë **vetave** ndë Israilit, edhe për shënjë të-kundrëfoluri; ³⁵ (Edhe tyj vetë shpirtinë një shpatë t’a ka për të depërtuarë); që të sbulonenë mendimet’ e shumë zëmërave.

³⁶ Edhe **atje** ishte Anna, një profitëreshë, e bij’ e Fanuilit, prej farës’ s’Asirit; këjo ishte shumë e shkuarë ndë dit, edhe kishte rruarë me burrinë shtatë vjet pas virgjëris’ së saj; ³⁷ Edhe këjo **ishte grua** e-ve sindonja tetë-dhjet’ e katrë vjeç, e-cila nukë ndahej prej hieroresë, dyke luturë me agjërimë e me të-falura nat’ e ditë. ³⁸ Edhe kjo, passi arriti nd’atë orë, lavdëronte Zonë, edhe u fliste për atë gjith’ atyreve që prisninë çpërrili ndë Jerusolim.

³⁹ Edhe si mbaruanë gjithë **punëtë** pas nomit të Zotit, ukthyenë ndë Galilet, ndë qytett të tyre Nazaret.

⁴⁰ Edhe djali rritej e forconej ndë frymë, dyke mbushurë me urtësi; edhe hir’ i Perëndisë ishte mbi atë.

⁴¹ Edhe prindërit’ e ati vininë për mot ndë Jerusolim për të-kremten’ e pashkësë.

⁴² Edhe kur ubë dy-mbë-dhjetë vjeç, ata hipnë ndë Jerusolim pas zakonit të së-kremtesë; ⁴³ Edhe si mbaruanë dittë, mbë të-kthyerit të tyre, djali Jisu mbeti prapa ndë Jerusolim; edhe Josifi edh’ e ëma nukë dijnë. ⁴⁴ Po dyke pandehurë, se ay ishte mb’udhë me shokëtë, ecnë një dit’ udhë; edhe e kërkoninë ndëpër far’ e fist e ndëpër të-njohurit. ⁴⁵ Edhe passi nuk’ e gjetnë, u kthyenë prapë ndë Jerusolim dyke kërkuar’ atë. ⁴⁶ Edhe pas tri ditsh e gjetnë ndë hieroret, dyke ndenjturë ndë mest të mësonjësvet, e dyke dëgjuar’ ata, e dyke pyetur’ ata. ⁴⁷ Edhe gjith’ ata që e dëgjoninë manitëshinë për mëndjen’ e për të-përgjegjurat e ati.

⁴⁸ Edhe kur e pan’ atë, uhabitnë; edhe e ëma i tha, O bir, ç’na bëre kështu? na yt atë edhe unë tek po të kërkojmë me pikëllim. ⁴⁹ Edhe **ay** u tha atyre, Përse më kërkonitë? nuk’ e dinitë, se unë duhetë të jem ndë punët të t’im et? ⁵⁰ Po ata nuk’ e kupëtuane fjalënë që u tha atyre.

⁵¹ Edhe sbriti bashkë me ata, edhe erdhi ndë Nazaret; edhe ishte dyk’ ubindurë nd’ata. Edhe e ëma ruante gjithë këto fjalë ndë zëmëret të saj. ⁵² Edhe Jisuj vinte mbarë nd’urtësi e ndë moshë e ndë hir përpara Perëndisë e njerëzet.

Krye 3

¹ Edhe mbë të-pesë-mbë-dhjetinë vit të mbretëris’ së Tiver Qesarit, kur Pilat Pondiu ishte qyvernitar i Judhesë, edhe Irodhi katrurdhëratës i Galilesë, e Filipi i vëllaj i ati katrurdhëratës i Ituresë edhe i vëndit të Trahonitisë, edhe Lysania katrurdhëratës i Avilinisë, ² Ndë ditt të kryeprihtërvet Annë e Kaiafë, erdhi fjal’ e Perëndisë mbë Joaninë të birrin’ e Zaharisë ndë shkretëtirët.

³ Edhe erdhi mbë gjithë vëndinë rrotullë Jordhanit, dyke lëçiturë pagëzim pendimi për ndjesën' e fajevet, ⁴ Sikundrë është shkruarë ndë vivlit të fjalëvet të profitit Isai, që thotë, "Zër' i ati që bërtet ndë shkretëtirët, Bëni gati udhën' e Zotit, bëni të-drejta rrugat' e ati. ⁵ Çdo vënt i-thellë dotë mbushetë, edhe çdo mal e kodrë dotë unjetë, edhe të-shtrëmbëratë dotë bënenë të-drejta, edhe udhët' e ashpëra të-sheshme; ⁶ edhe çdo mish dotë shohë shpëtimn' e Israilit".

⁷ U thoshte pra gjindjevet që vininë jashtë që të pagëzonesthinë prej ati, Të-pjellë nepërkash, kush udfetue juve të ikëni prej zëmërimit që ka për të ardhurë? ⁸ Bëni pra pemë të-vëjjeura për pendim, edhe mos ziri të thoni me vetëhenë t'uaj, **se** Atë kemi Avraaminë; sepse po u them juve, se Perëndia munt prej këtyre gurëve t'i ngrerë djem Avraamit. ⁹ Edhe tashi edhe sēpata gjëndetë ndë rrënjët të drurëvet; çdo dru pra që nukë bën pemë të-mirë, pritetë edhe hidhetë ndë zjarr.

¹⁰ Edhe gjindja e pyesninë, dyke thënë, Ç'të bëjmë pra? ¹¹ Edhe ay upërgjeq e u thot' atyre, kush ka dy robra let'i apë pjesë ati që s'ka; edhe kush ka të-ngrëna, gjithashtu letë bënë.

¹² Erdhë edhe kumerqarë që të pagëzonesthinë, edhe i thanë, Mësonjës, ç'të bëjmë? ¹³ Edhe ay u thot' atyre, Mos merrni gjë më tepërë veç asaj që është urdhëruarë mbë ju.

¹⁴ Edhe e pyesnin' atë edhe t'atillë që venë ushtëtarë, dyke thënë, Edhe na ç'të bëjmë? Edhe u tha atyre, Mos bëni shtrëngim as njeriu, as mos kallëzoni keq **për njeri**; edhe let'u jenë mjaft pagatë t'uaj.

¹⁵ Edhe llauzi tek po ishte dyke priturë, edhe të-gjithë mendonesthinë ndë zëmërat të tyre për Joaninë, vallë mos është' ay Krishti, ¹⁶ Joani upërgjeq të-gjithëve, dyke thënë, Unë u pagëzonj juve me ujë; po vjen më i-forti se unë, të-cilit s'jam i-zoti t'i sgjith rripn' e shollavet t'ati; ay dot'u pagëzonjë juve me Frymë të-Shënjtëruarë e me zjarr; ¹⁷ I-cili **mban** lopatënë ndë dorët të ti, edhe dotë qëronjë lëmën' e ti, edhe dotë mblethnjë grurëtë ndë grunart të ti, edhe kashtënë dot'a djegë ndë zjarr të-pashuarë.

¹⁸ Edhe shumë të-tjera dyke mësuarë llauzit i epte ati zën' e-mirë.

¹⁹ Edhe Irodhi katrurdhëratësi, passi qërtonej prej ati për Irodhiadhënë gruan' e të vëllat të ti (Filip), edhe për gjithë të-këqiatë që pat bërë Irodhi, ²⁰ Shtoj edhe këtë përmbi të-gjitha, edhe mbylli Joannë ndë burg.

²¹ Edhe passi u pagëzua gjithë llauzi, upagëzua edhe Jisuj, edhe tek ishte dyke falurë, uhap qielli, ²² Edhe Frym' e-Shënjtëruarë sbriti mbi atë me një farë trupi posi pëllump, edhe erdhi një zë nga qielli, dyke thënë, Ti je Biri im i-dashuri, ty të kam pëlqyerë.

²³ Edhe vetë Jisuj zuri të jetë afëro tri-dhjetë vjeç, edhe ishte (si e pandehninë **bota**) i bir' i Josifit, i Iliut, ²⁴ i Matthanit, i Leviut, i Mehiut, i Annajt, i Josifit, ²⁵ i Matthiut, i Amosit, i Naumit, i Esliut, i Naggajt, ²⁶ i Maathit, i Mattathiut, i Semejt, i Josifit, i Judhësë, ²⁷ i Jonnajt, i Risajt, i Zorovavelit, i Sallathiit, i Niriut, ²⁸ i Melhiut, i Addhiut, i Kosamit, i Elmodhamit, i Irit, ²⁹ i Josiut, i Eliezerit, i Joreimit, i Matthatit, i Leviut, ³⁰ i Simeonit, i Judhesë, i Josifit, i Jonanit, i Eliaqimit, ³¹ i Meleajt, i Mainanit, i Mattathajt, i Nathanit, i Dhavidhit, ³² i Jeseut, i Ovidhit, i Voozit, i Sallmonit, i Naasonit, ³³ i Aminadhavit, i Aramit, i Esromit, i Faresit, i Judhësë, ³⁴ i Jakovit, i Isaakut, i Avraamit, i Tharajt, i Nahorit, ³⁵ i Saruhut, i Ragavit, i Falekut, i Everit, i Sallajt, ³⁶ i Kainanit, i Arfaksadhrit, i Simit, i Noesë, i Llamëhut, ³⁷ i Mathusallesë, i Enohut, i Jaredit, i Maleleilit, i Kainanit, ³⁸ i Enosit, i Sithit, i Adhamit, i Perëndisë.

Krye 4

¹ Edhe Jisuj plot me Frymë të-Shënjtëruarë ukthye nga Jordhani; edhe upru me anë të Frymësë ndë shkretëtirë, ² **Ku ishte** dyke ngarë nga djalli dy-zet dit; Edhe

nukë hëngri asgjë nd' ato dit; edhe si umbushnë ato, pastaj i erdhi uri. ³ Edhe djalli i tha, Ndë je i Bir' i Perëndisë, thuai këti guri të bënë të bukë. ⁴ Edhe Jisuj i upërgjeq ati, dyke thënë, Eshtë shkruarë, "Se njeriu nukë dotë rronjë vetëmë me bukë, po me çdo fjalë të Perëndisë." ⁵ Edhe djalli e hipi mbë **një** mal të-lartë, e i dëftën ati gjithë mbretërit' e botësë për **një** grimë here. ⁶ Edhe djalli i tha, Tyj dotë t'a ap tërë këtë pushtet edhe lavdin' e atyre sepse mua m'është dhënë, edhe kujt të dua ja ap; ⁷ Ti pra ndë ufalç përpara meje, të-gjitha dotë jenë t'ëndetë. ⁸ Po Jisuj upërgjeq e i-tha, (Çporu prapa meje, Satana, sepse) është shkruarë, "Zotit Perëndisë t'ënt dot'i falesh, edhe vetëm' atij dot'i lutesh." ⁹ Edhe ay e pruri atë ndë Jerusolim, edhe e qëndroj mbi fletëzët të hieroresë, edhe i tha, Ndë je i Bir' i Perëndisë, hith vetëhenë t'ënde së-këtejmi poshtë; ¹⁰ Sepse është shkruarë, "Se dotë urdhëronjë ëngjëjt' e ti për ty, që të të ruanjë," ¹¹ Edhe "Se dotë të ngrënë ty mbi duart, që të mos përplek këmbënë t'ënde mbë gur." ¹² Edhe Jisuj upërgjeq e i tha, Se është thënë, "Nukë ke për të ngarë Zotinë Perëndinë t'ënt."

¹³ Edhe djalli passi mbaroj çdo ngasje, ulargua prej ati gjer mbë një kohë.

¹⁴ Edhe Jisuj ukthye mbi fuqin' e Frymësë ndë Galilet; edhe doli zë për atë mbë gjithë vëndinë rrotullë. ¹⁵ Edhe ay mësonte ndëpër sinagogjit t'atyreve, dyke lavduruarë prej të-gjithëve.

¹⁶ Edhe erdhi ndë Nazaret, atje ku ishte rriturë; edhe pas zakonit të ti hyri ndë sinagogjit ditën' e-shëtunë, edhe ungrit të këndonjë. ¹⁷ Edhe **ata** i dhanë, vivllin' e profitit Isai; edhe si hapi vivlinë gjeti vëndinë, ku ishte shkruarë, ¹⁸ "Frym' e Zotit **është** mbë mua; përandaj më leu **me vaj**; më dërroj t'u ap zën' e-mirë të-vobeqvet, të shëronj ata që kanë zëmërenë të-thyerë, ¹⁹ t'u lëçis skllevet liri, edhe të-verbërvet të-hapurë të syvet, edhe të dërgonj ata që janë ndënë mundim ndë liri; Të lëçis mot të-pëlqyerë te Zoti."

²⁰ Edhe si mbylli vivllënë, j'a dha shërbëtorit, edhe ndënji; edhe syt' e gjith' **atyreve që ishinë** ndë sinagogjit ishinë dyke shikuarë mbi atë.

²¹ Edhe zuri t'u thoshte atyre, Se sot umbush kjo shkronjë ndë veshët t'auj.

²² Edhe të-gjithë dëshmoninë mb'atë, edhe çuditëshinë për fjalët' e hirit që dilninë prej gojës s'ati, edhe thoshinë, Nuk' është ky i bir' i Josifit? ²³ Edhe **ay** u tha atyre, pa fjalë dotë më thoni këtë paravoli, Mjekës, shëro vetëhenë t'ënde; sa dëgjua më që janë bërë ndë Kapernaum, bëj-i edhe këtu ndë atdhet t'ënt. ²⁴ Po ay tha, Me të vërtetë po u them juve, se asndonjë profit nuk' është i-pëlqyerë ndë atdhet të ti.

²⁵ Edhe me të-vërtetë po u them juve, Shumë **gra** të-va ishinë ndë Israillt ndë diit të lliut kur umbyll qielli tre vjet e gjashtë muaj, ndë të-cilët kohë ubë një zi e-madhe mbë gjithë dhenë; ²⁶ Po as mbë ndonjë nga ato nuk' udërgua lliu, përveç ndë Sareptë të Sidhonësë ndë një grua të-ve. ²⁷ Edhe shumë të-kromosurë ishinë ndë Israillt ndë diit të profitit Elisse; po asndonjë nga ata nuk' uqërua, përveç Neeman Syrjani.

²⁸ Edhe gjith' **ata që ishinë** ndë Sinagogjit, kur dëgjuanë këto, umbushnë me zëmërim. ²⁹ Edhe ungritnë edhe e nxuarrë jashtë qytetit; edhe e prunë gjer ndë buzët të malit, përmbi të-cilinë ishte ndërtuarë qytet' i atyre, që t'a rrëzoninë përposh. ³⁰ Po ay shkoj ndëpër mest t'atyreve, edhe iku.

³¹ Edhe sbriti ndë Kapernaum, q'është një qytet i Galilesë; e ishte dyke mësuarë ata të-shëtunatë. ³² Edhe manitëshinë për mësimn' e ati; sepse fjal' e ati ishte me pushtet.

³³ Edhe ndë sinagogjit ishte një njeri që kishte frymë djalli të-ndyrë, edhe bërtiti me zë të-math, ³⁴ Dyke thënë, Mjerë! ç'ke me ne ti, Jisu Nazarinas? erdhe të na humbaç? Të njoh cili je, Shënjt i Perëndisë. ³⁵ Po Jisuj e qërtoj, dyke thënë, Pusho, edhe dil prej ati. Edhe djalli si e hodhi ndë mest, doli prej ati, pa bërë asfare dëm ati. ³⁶ Edhe të-gjithë uhabitnë, edhe flisninë njëri me tjetrinë, dyke thënë, **Ç'është**

këjo fjalë, që me pushtet e me fuqi urdhëron frymat' e-ndyra, edhe dalënë? ³⁷ Edhe përhapej zë për atë ndë çdo anë të vëndit rrotullë.

³⁸ Edhe si ungrit prej sinagogjisë, hyri ndë shtëpit të Simonit, edhe të vjehërrën' e Simonit e kishinë zënë ethe të-médha; edhe i ulutnë për atë. ³⁹ Edhe **ay** si ndënji sipër' asaj, i qërtoj ethetë, edhe e lanë; edhe **ajo** për-një-here ungrit e u shërbente.

⁴⁰ Edhe kur po perëndonte djelli, gjithë sa kishinë të-sëmurë prej çdo farë lëngatash, i prunë tek ay; edhe ay dyke vënë duartë mbi sicilinedo nga ata, i shëroj ata. ⁴¹ Edhe prej shumë vetave diininë edhe djaj dyke klithur' e dyke thënë, Se ti je Krishti, i bir' i Perëndisë. Edhe **ay** dyke qërtuarë s'i linte të flisninë, sepse e njihninë se ay ish Krishti.

⁴² Edhe si ubë ditë, dolli e vate ndë një vënt të-shkretë; edhe gjindja e kërkonin' atë, edhe erdhë gjer aty; edhe e mbaninë, që të mos ikënte prej atyreve. ⁴³ Po ay u tha atyre, Se edhe ndëpër të-tjerët qytete duhetë të ap zën' e mirë për mbretërin' e Perëndisë; sepse për këtë jam dërguarë. ⁴⁴ Edhe ishte dyke lëçiturë ndëpër sinagogjit të Galilesë.

Krye 5

¹ Edhe gjindja tek po ishte dyke shtrënguar' atë që të dëgjoninë fjalën' e Perëndisë, ay qëndronte përanë lëqerit Gjenisaret. ² Edhe pa dy lundra dyke qëndruarë përanë **buzës'** së lëqerit; edhe peshkatarëtë duallë nga ato, e laninë rrietatë. ³ Edhe **ay** hyri mbë njërënë nga lundratë, mb'atë që ishte e Simonit, edhe i ulut ati të largonej pak prej tokësë. Edhe si ndënji mësonte gjindjenë nga lundra.

⁴ Edhe si pushoj së-foluri, i tha Simonit, Sill **lundrënë** ndë **ujërat** të-thella, edhe hithni rrietatë t'uaj, që të zini pishq. ⁵ Edhe Simonu upërgjeq e i tha, Mësonjës, gjithë natën' umunduamë, edhe nukë zumë gjë; po për fjalënë t'ënde dot' e heth rrietënë. ⁶ Edhe si bënë këtë, mbyllnë brënda një shumicë pishqish të-madhe, edhe rrieta e atyreve po çirej. ⁷ Edhe u bënë me shënjë shokëvet që ishinë ndë lundrët tjetërë, që të vinin' e t'u ndih-moninë; edhe **ata** erdhë, edhe mbushnë të dy lundratë, kaqë, sa ato **zunë të** fundoseshinë. ⁸ Edhe Simon Pjetri, kur pa, ra ndër gjunjët të Jisujt, dyke thënë, Dil prej meje, Zot, sepse jam njeri fajtuar. ⁹ Sepse të-habiturë e pushtoj atë edhe ata që ishinë bashkë me atë, për gjahun' e pishqvet që zunë; ¹⁰ Gjithashtu edhe Jakovin' e Joannë, të bijt' e Zevedheut, të-cilëtë ishin shokë të Simonit. Edhe Jisuj i tha Simonit, Mos ki frikë, se paskëtaj dotë gjuanc njerës. ¹¹ Edhe si suallë lundratë mbë tokët, i lanë të-gjitha edhe vanë pas ati.

¹² Edhe ay kur ishte ndë një nga qytetetë, javoka një njeri plot me kromë; i-cili, kur pa Jisunë, ra përmbys, edhe i ulut, dyke thënë, Zot, ndë do, munt të më qërojsh. ¹³ Edhe **ay** ndejti dorënë, e e preku, edhe tha, Dua, Qërohu. Edhe sa-kaqë-herash krroma iku prej ati. ¹⁴ Edhe ay e porositi të mos i thotë asnjëriu; po ecë, **thotë**, e défte vetëhenë t'ënde te prifti, edhe bjerë dhuratë për të-qëruarëtë t'ënt, sikundrë ka urdhëruarë Moisiu, për dëshmim mb'ata.

¹⁵ Po fjala dilte më tepërë për atë. Edhe shumë gjndje përmblihdeshinë për të dëgjuar' e për të shëruarë prej ati nga smundjet' e tyre. ¹⁶ Po ay hiqej ndë shkretëtirat, edhe falej.

¹⁷ Edhe një ditë, tek ay ishte dyke mësuarë, rrininë Farisenj e nommësonjës, të-cilëtë kishin' ardhurë nga çdo fshat i Galilesë e i Judhesë e i Jerusalamit; edhe fuqi' e Zotit ishte për të shëruar' ata. ¹⁸ Edhe javoka, **ca** njerës sillninë mbë shtrat një njeri, i-cili ishte ulok; edhe kërkoninë t'a sillninë brënda, e t'a vininë përpara ati. ¹⁹ Edhe passi s'gjetnë prej ç'ane t'a bininë brënda nga gjindja **e-shumë**, hipnë mbi shtëpit, edhe e sbritnë nga qeramidhetë bashkë me shtratinë ndë mest përpara Jisujt. ²⁰ Edhe **ay** kur pa besën' e atyre, i tha ati, O njeri, të janë ndjerë fajet' e tu. ²¹ Edhe shkronjësit' e Farisenjtë zunë të mendonëshinë, dyke thënë, Cili është ky

që flet vllasfimira? kush munt të ndjenjë faje, përveç vetëmë Perëndia? ²² Po Jisuj si kupëtoj mendimet' e atyreve, upërgjeq e u tha atyre, Ç'mendoni ndë zëmërat t'uaja? ²³ Ç'është më kollaj të them, Të janë ndërë fajet' e tu, apo të them, Ngreu edhe ecë? ²⁴ Po që të dini, se i Bir' i njeriut ka pushtet mbi dhet të ndjenjë faje, (i tha ulogut); Tyj të them, Ngreu, edhe ngri shtratinë t'ënt, edhe ecë ndë shtëpit t'ënde. ²⁵ Edhe për-një-here ungrit përpara atyreve, edhe ngri shtratinë, mbë të-cilinë dergjej, edhe shkoj ndë shtëpit të ti, dyke lavduruarë Perëndinë. ²⁶ Edhe **një** të-maniturë pushtoj të-gjithë, edhe lavduroninë Perëndinë; edhe umbushnë me frikë, dyke thënë, Se sot pamë **punë** të mançime.

²⁷ Edhe pasandaj doli, edhe pa **një** kumerqar, që **e kishte** emërinë Levi, dyke ndënjurë ndë kumerqt, edhe i tha, Eja pas meje. ²⁸ Edhe ay la të-gjitha, edhe ungrit e vate pas ati.

²⁹ Edhe Levii i bëri një të-priturë të-math ndë shtëpit të ti; edhe ishte shumë gjindje kumerqarësh edhe të-tjerësh, që kishinë ndënjurë ndë mësallët bashkë me ata. ³⁰ Edhe shkronjësit' e atyre e Farisenjtë murmurisininë te nxënësit' e ati, dyke thënë, Përse hani e pini bashkë me kumerqar' e me fajtorë? ³¹ Edhe Jisuj upërgjeq e u tha atyre, Nukë kanë nevojë të-shëndoshëtë për shëronjës, po ata që kanë keq. ³² S'kam ardhurë të gërshes të-drejtë, po fajtorë ndë pendim.

³³ Edhe ata i thanë, Përse nxënësit' e Joanit agjëronjënë dëndurë, edhe bëjnë të-lutura, gjithashtu edhe ata të Farisenjvet, po të-tutë han' e pinë? ³⁴ Edhe ay u tha atyre, Mos muntni të bëni dasmorëtë të agjëronjënë gjer sa të jetë dhëndëri bashkë me ata? ³⁵ Po kanë për të ardhurë dit, kur dotë merretë dhëndëri prej atyreve; atëhere nd'ato dit dot' agjëronjënë. ³⁶ Edhe u thoshte atyre edhe **një** paravoli, Se asndonjë nukë vë andërrë robe së-re mbi robë të-vjetërë; ndë mos, edhe të-renë e çjer, edhe andëri prej së-resë s'vjen një me të-vjetërë. ³⁷ Edhe asndonjë nukë vë verë të-re ndë calikë të-vjetërë; ndë mos, ver' e-re dot'i plasnjë calikëtë, edhe ajo dotë derdhetë, edhe calikëtë dotë prishenë. ³⁸ Po ver' e-re duhetë të viretë ndë calikë të-rinj, edhe **kështu** të dyja ruhenë. ³⁹ Edhe asndonjë, passi të pijë **verë** të-vjetërë, do sa-kaqë-herash të-re, sepse, thotë, e-vjetëra është më e-mirë.

Krye 6

¹ Edhe të-shëtunën' e-dytë pas së-parësë ay po shkonte ndëpër të-mbjellat; edhe nxënësit' e ati këputinë kallinj, e haninë, dyke fërkuarë me duartë. ² Edhe ca nga Farisenjtë u than' atyre, Përse bëni atë që nuk' është e udhësë t'a bëni të-shëtunatë? ³ Edhe Jisuj upërgjeq e u tha atyre, Nuk' e kini kënduarë as këtë që bëri Dhavidhi, kur i erdhi uri ati edhe atyre që ishinë bashkë me atë? ⁴ Qysh hyri ndë shtëpit të Perëndisë, edhe mori bukët' e parëvënjesë, edhe hëngri, edhe u dha edhe atyreve që ishinë bashkë me atë, të-cilatë nuk' është e udhësë t'i hanë përveç vetëmë prifëritë? ⁵ Edhe u thoshte atyre, Se i Bir' i njeriut është i zoti edhe i së-shëtunësë.

⁶ Edhe përsëri **një** tjetërë të-shëtunë hyri ndë sinagogjit, edhe mësonte; edhe atje ishte një njeri që kishte dorën' e ti të-thatë. ⁷ Edhe shkronjësit' e Farisenjt' e vështroninë, ndë dotë shëronjë të-shëtunë, që të gjeninë **çkak** të-përfoluri kundrë ati. ⁸ Po ay i dinte mendimet e atyreve, e i tha njeriut, që kishte dorën' e-thatë, Ngreu, edhe qëndro ndë mest. Edhe ay ungrit edhe qëndroj. ⁹ Jisuj u tha pra atyre, Dot' u pyes juve një gjë, është e udhësë të-shëtunatë të bënë njeriu mirë, a po të bënë keq? të shpëtonjë shpirt, a po të humpnjë? ¹⁰ Edhe pasi vuri re rrotullë gjith' ata, i tha njeriut, Ndej dorënë t'ënde. Edhe ay bëri ashtu, edhe dor' e ati ubë e-shëndoshë posi tjetëra. ¹¹ Po ata umbushnë mëri, edhe flisninë njëri me tjetrinë, ç't'i bënë Jisujt.

¹² Edhe nd'ato dit dolli ndë malt të falej, edhe e shkoj natënë dyke falurë Perëndisë.

¹³ Edhe kur ubë ditë, thirri nxënësit' e ti, edhe sgjodhi nga ata dy-mbë-dhjetë, edhe i quajti apostoj; ¹⁴ Simoninë, të-cilinë edhe e quajti Pjetër, edhe Andrenë, të vëllan' e ati, Jakovin' edhe Joaninë, Filipin' e Varthollomenë, ¹⁵ Matthenë edhe Thomanë, Jakovin' e Alfeut, edhe Simoninë që uquajt Zilloti, ¹⁶ Judhënë, **të-vëllan'** e Jakovit, edhe Judhë Iskariotinë, i-cili ubë edhe trathëtar.

¹⁷ Edhe sbriti bashkë me ata, e qëndroj mbë një vënt të-sheshm; edhe **ishinë** gjindje nga nxënësit' e ati, edhe shumë shumicë llauzi nga gjithë Judhea edhe nga Jerusalmi, edhe an' e detit të Tyrës' e të Sidhonësë, të-cilëtë erdhë të dëgjonin' atë, edhe të-shëroneshinë nga smundjet' e tyre; ¹⁸ Edhe ata që mundoneshinë prej frymave të-ndyra, edhe shëroneshinë. ¹⁹ Edhe gjithë gjindja kërkoninë t'a prekninë; sepse dilte fuqi prej ati, edhe shëronte të-gjithë.

²⁰ Edhe ay, si ngriti syt' e ti mbë nxënësit' e ti, thoshte,

Lum **ju** të-vobeqtë, sepse juaja është mbre-tëri' e Perëndisë. ²¹ Lum **ju** që keni uri tashti, sepse dotë ngjjeni. ²² Lum **ju** që qani tashti, sepse dotë qeshni. Të-lumturë jeni **ju**; kur t'u kenë çmir juve njerëzitë, edhe kur t'u veçonjënë, edhe t'u shanjënë, edhe t'u nxjerën' emërinë për të-keq, për punë të Birit të njeriut.

²³ Gëzohi nd'atë ditë edhe këceni; sepse na paga juaj tek **është** e-shumë ndë qiellit; sepse kështu u'a bënë **edhe** profitërvet atërit' e atyreve. ²⁴ Po mjerë ju të-pasuritë, sepse e muartë ngushulliminë t'uaj. ²⁵ Mjerë ju të-nginjuritë, se dotë keni uri. Mjerë ju që qeshni tashti, se dotë mbani zi e dotë qani, ²⁶ Mjerë ju, kur (gjithë) njerëzitë të flasënë mirë për ju; sepse kështu u'a bënë edhe profitërvet gënjeshtarë atërit' e atyre.

²⁷ Po u them juve që dëgjoni, Doni armiqtë t'uaj; bëj-u-ni mirë atyreve që u kanë çmir; ²⁸ Bekoni ata që u mallëkonjënë; edhe faluni për ata që u dëmëtonjënë.

²⁹ Ati që të të bjerë **shuplakë** ndë faqet, kthe-i edhe t'atërinë, edhe ati që të merr rrobënë t'ënde, mos **i** ndalo edhe këmishënë. ³⁰ Edhe kujdo që lypën prej teje ep-i, edhe ati që merr të-tuatë, mos j'a lyp prapë. ³¹ Edhe sikundrë doni t'u bënë juve njerëzitë, edhe ju bëni atyreve gjithashtu. ³² Edhe ndë daçi ata që u duanë juve, çfarë hiri kini ju? sepse edhe fajtorëtë duan' ata që i duanë. ³³ Edhe ndë u bëfshi mirë atyreve, që ubënjënë mirë juve, ç'farë hiri keni ju? sepse edhe fajtorëtë gjithatë bënë. ³⁴ Edhe ndë u dhënçi hua **atyreve**, prej të-cilëvet shpreni t'i merrni prapë, ç'farë hiri keni ju? sepse edhe fajtorëtë u apënë hua fajtorëvet, që t'i marrënë prapë një nga një. ³⁵ Po doni armiqtë t'uaj, edhe bëni mirë, edhe epni hua, pa pasurë ndonjë shpresë më; edhe **atëhere** paga juaj dotë jet' e-shumë, edhe dotë jini të bijt' e të-Lartit; sepse ay është i-mirë mb'ata që nuk j'a njohënë të-mirënë edhe mbë të-këqinjëtë. ³⁶ Bëhi pra të-përdëlyershim, sikundrë edhe ati juaj është i-përdëlyershim.

³⁷ Edhe mos gjykoni, edhe nukë dotë gjykohi; mos dënoni, edhe nukë dotë dënohi; ndjeni, edhe dotë ndjehi. ³⁸ Epni, edhe dot' u epetë juve; masë të-mirë, të-ngjeshur' e të-tundur' e të-derdhurë prej buze dot' u apënë ndë gjit' uaj; sepse me gjith atë masë që matni, dot' u matetë edhe juve.

³⁹ Edhe u tha atyre **një** paravoli: mos munt i-verbërë t'i heqë udhë të-verbërit' a nukë dotë bjenë që të dy ndë gropë? ⁴⁰ Nukë ka nxënës përmbi mësonjësin' e ti; po çdo i-mbaruarë **nxënës** dotë jetë si mësonjësi i ti.

⁴¹ Edhe përse shikon lëmishtenë që është ndë syt të t'yt vëllaj, edhe tranë që është ndë syt t'ënt nuk' e ndjen? ⁴² Apo si munt t'i thuash t'yt vëllaj, Vëlla, dal të nxjer lëmishtenë që ke ndë syt t'ënt, kur ti nukë sheh tranë që **është** ndë syt t'ënt? Ipokrit, nxir më përpara tranë prej syrit t'ënt, edhe atëhere dotë shohç mirë të nxjerç lëmishtenë që **është** ndë syt të t'yt vëllaj.

⁴³ Sepse nuk ë ka dru të-mirë që të bënjë pemë të-kalburë; as dru të-kalburë që të bënjë pemë të-mirë. ⁴⁴ Sepse çdo dru njihetë prej pemës' së ti; sepse nuk ë mbledhënë fiq nga drizatë, as nuk ë vjelënë rrush nga ferratë. ⁴⁵ Njeriu i-mirë nxjer të-mirënë prej thesarit të-mirë të zëmërës' së ti; edhe njeriu i-lik nxjer të-ligënë prej thesarit të-lik të zëmërës' së ti; sepse goj' e ati flet nga të-tepërët' e zëmërësë.

⁴⁶ Edhe përse të thërritni, Zot, Zot, edhe nukë bëni sa them? ⁴⁷ Kushdo që vjen tek unë, edhe dëgjon fjalët' e mia, edhe i bën, dot'u dëftenj juve me cilinë gjan; ⁴⁸ Gjan me **një** njeri që ndërtonte **një** shtëpi, i-cili miu e thelloj, edhe shtyri themeli mbi shkëmpt; edhe kur rruhdë ujëratë, upërpoq lumi kundrë asaj shtëpie, edhe nukë mundi t'a tuntnjë; sepse ishte themelosurë mbi shkëmpt. ⁴⁹ Po ay që të dëgjonjë e të mos bënjë, gjan me një njeri që ndërtoj shtëpi mbi dhet pa themeli; kundrë së-cilësë upërpoq lumi, edhe për-një-here ra, edhe të-rrëzuarët' e asaj shtëpie ubë të-math.

Krye 7

¹ Edhe passi mbaroj gjithë fjalët' e ti ndë veshët të llauzit, hyri ndë Kapernaum.

² Edhe shërbëtori i një krye-qindësi, që e kishte shumë të-vëjyerë, ishte keq për të vdekurë. ³ Edhe kur dëgjoj për Jisunë, dërgoj pleqt' e Judhenjvet tek ay dyke lutur' ati të vint' e t'i shpëtonte shërbëtorinë. ⁴ Edhe ata erdhë te Jisuj e i luteshinë me të-tepërë, dyke thënë, Se është i-vëjejturë ay, të-cilit dot'j'a bësh këtë. ⁵ Sepse ay e do kombinë t'ënë, edhe sinagogjinë ay na e ka ndërtuarë. ⁶ Edhe Jisuj ecënte bashkë me ata.

Edhe atje tek ishte jo lark shtëpisë, kryeqindësi dërgoj miq tek ay, dyke thënë ati, Zot, mos u-mundo, sepse nukë jam i-zoti që të hynjç ndënë strehët t'ime; ⁷ Përandaj as vetëhenë t'ime s'e gjeta të-vëjejturë të vinj tek ti; po thuaj një fjalë, edhe shërbëtori im dotë shëronetë. ⁸ Sepse edhe unë jam një njeri ndënë urdhër, edhe kam ndënë vetëhenë t'ime shërbëtorë; edhe i them këti, Ecë, edhe vete; edhe tjetërit, Eja, edhe vjen; edhe shërbëtorit t'im. Bëj këtë, edhe e bën. ⁹ Edhe Jisuj kur dëgjoj këto, uçudit për atë, edhe ukthye, e i tha gjindjesë që i vinte pas, Po u them juve, **se** as ndë Israilit s'kam gjeturë kaqë besë. ¹⁰ Edhe ata që ishinë dërguarë, kur ukthyenë ndë shtëpit, gjetnë shërbëtorin' e-sëmurë të-shëndoshurë.

¹¹ Edhe mbë të-nesërmet **Jisuj** vinte ndë **një** qytet që quhej Nain; edhe vininë bashkë me atë **edhe** mjaft nga nxënësit' e ti, edhe shumë gjindje. ¹² Edhe kur uafërua në portët të qytetit, ja tek sillninë përjashta një të-vdekurë, **të-cilinë** e-ëma e kishte bir të-vetëmë, edhe ajo **ishte** e-ve; edhe shumë gjindje **prej** qytetit ishte bashkë me atë. ¹³ Edhe Zoti kur pa atë, i erdhi keq për atë, edhe i tha asaj, Mos qaj. ¹⁴ Edhe uafërua e zuri shtratinë; edhe ata që e mbaninë qëndruanë; edhe tha, Djalosh, po të them, ngreu. ¹⁵ Edhe i-vdekuri ungrit e ndënji, edhe zuri të flasë. Edhe j'a dha s'ëmësë. ¹⁶ Edhe të-gjithëve u hyri frikë, edhe lavduroninë Perëndinë, dyke thënë, Se profit i-math është ngriturë ndër ne, edhe se Perëndia vuri re llauzin' e ti. ¹⁷ Edhe doli kjo fjalë për atë ndëpër gjithë Judhenë, edhe ndëpër gjithë vëndetë rrotullë.

¹⁸ Edhe nxënësit' e ti dhanë zë Joanit për gjithë këto.

¹⁹ Edhe Joani thirri përënë dy **veta** nga nxënësit' e ti, e i dërgoj te Jisuj, dyke thënë, Ti je ay që ka për të ardhurë, apo presmë tjetërë? ²⁰ Edhe njerëzitë, si erdhë tek ay, thanë, Joan Pagëzori na ka dërguarë te ti, dyke thënë, Ti je ay që ka për të ardhurë, apo presmë tjetërë? ²¹ Edhe nd'atë ore **ay** shëroj shumë **veta** nga smundjet' e nga mundimet' e nga frymat' e-liga, edhe shumë të-verbërve u fali të-parëtë. ²² Edhe Jisuj upërgjeq e u tha atyre, Ecëni e epni zë Joanit për gjithë sa patë e dëgjuatë, se të-verbërë shohënë, të-çalë ecëjnë, të-krmosurë qëronenë,

të-shurdhërë dëgjonjënë, të-vdekurë ngjallenë, të-vobeq dëgjonjënë zën' e-mirë;

²³ Edhe lum ay që të mos skandalisetë mbë mua.

²⁴ Edhe passi iknë ata që ishinë dërguarë nga Joani, zuri t'i thoshte gjindjesë për Joaninë, Ç'kini dalë ndë shkretëtirët të shihni? kallam që tundetë nga era? ²⁵ Po ç'kini dalë të shihni? njeri të-veshurë **me** rroba të-butë? na ata që janë veshurë me rroba të-ndritura e që rrojnë ndër të-kënaqura tek janë ndëpër **dyert** të mbretërvet. ²⁶ Po ç'kini dalë të shihni? profit? Po, u them juve, edhe më tepërë se profit. ²⁷ Ky është **ay**, për të-cilinë është shkruarë, "Na unë tek po dërgonj ëngjëllinë t'im përpara faqesë s'ate, ay dotë ndreqnjë udhënë t'ënde përpara teje." ²⁸ Sepse po u them juve, ndë mest t'atyre që kanë lindurë prej grash asndonjë nuk' është më i-math se ay.

²⁹ Edhe gjithë llauzi që dëgjuan' **atë**, edhe kumerqarëtë, drejtëruanë Perëndinë, dyke pagëzuarë vetëhen' e tyre me pagëzimn' e Joanit. ³⁰ Po Farisenjt' edhe nomtarëtë e hodhë tej prej vetëhes' së tyre andën' e Perëndisë, sepse nuk' upagëzuanë prej ati.

³¹ (Edhe Zoti tha,) Me se t'i përgjanj pra njerëzit' e këti brezi? edhe me se gjanjënë? ³² Gjanjënë me çuna që rrinë ndë trekt edhe që thërresënë njeri tjatrit, dyke thënë, I ramë fyellit për ju, edhe nukë këcyetë; u bëmë vajë, edhe nukë qatë. ³³ Sepse erdhi Joan Pagëzori, që as bukë ha, as verë pi, edhe thoni, **se** Ka djallë. ³⁴ Erdhi i Bir' i njeriut dyke ngrën' e dyke pirë, edhe thoni, Na njeri hamës e verë-pirës, mik i kumerqarëve e i fajtorëve. ³⁵ Edhe udrejterua urtësia prej gjithë bijvet të saj.

³⁶ Edhe një nga Farisenjtë i lutej të hajë bashkë me atë; edhe **ay** hyri ndë shtëpit të Fariseut, edhe ndënji ndë mësallët.

³⁷ Edhe javoka, një grua nd'**atë** qytet, e-cila ishte fajtoe, kur mori vesh, se kishte rënë ndë shtëpit të Fariseut, pruri **një** allavastrë me vaj erërash; ³⁸ Edhe ndënji prapa përënë këmbëvet t'ati dyke qarë, edhe zuri e lakte këmbët' e ati me lottë, edhe j'a fshinte me flokët' e kres' së saj, edhe puthte këmbët' e ati, edhe **j'a** lyente me vajin' e erëravet. ³⁹ Edhe Fariseu që e kish thërriturë, kur pa, tha me vetëhen' e ti, dyke thënë, Ky po të ishte profit, dotë njihte cila edhe ç'farë gruaje **është** ajo që e prek, se është fajtoe.

⁴⁰ Edhe Jisuj i upërgjeq e i tha ati, Simon, diç kam të të them. Edhe ay i thotë, Mësonjës, thuaj. ⁴¹ Një hua-dhënës kishte dy detorë; njëri i kishte detyrë pesë qint dinarë, edhe tjetëri pesë-dhjetë. ⁴² Edhe passi nukë kishinë t'j'a laninë, u'a fali të dyve. Thuaj pra, Cili nga ata dot'e dojë më tepërë? ⁴³ Edhe Simoni upërgjeq e tha, Më duketë, se ay, të-cilit i fali më të-shumatë. Edhe ay i tha, Drejtë gjykove.

⁴⁴ Edhe si ukthye nga gruaja, i tha Simonit, A e sheh këtë grua? Hyra ndë shtëpit t'ënde, **edhe ti** nukë më dhe ujë **për të larë** këmbëtë; po ajo me lottë më lagu këmbëtë, edhe me flokët' (e kres' së saj) i fshiu. ⁴⁵ **Ti** nukë më puthë; po ajo, që kur hyra, nukë pushoj dyke puthurë këmbët' e mia. ⁴⁶ **Ti** me vaj nukë më leve kryetë; po ajo me vaj erërash më leu këmbëtë. ⁴⁷ Përandaj po të them, Janë ndërë fajet' e asaj të-shumë; sepse deshi shumë; po ati që i ndjenenë pak, pak do. ⁴⁸ Pastaj i tha asaj, Të janë ndërë fajetë. ⁴⁹ Edhe ata që kishinë ndënjurë ndë mësallët zunë të thonë me vetëhen' e tyre, Cili është ky që edhe faje ndjen? ⁵⁰ Edhe ay i tha gruasë, Besa jote të shpëtoj; hiq ndë paqtim.

Krye 8

¹ Edhe pastaj ay vij qytet mbë qytet e fshat mbë fshat, dyke lëçitur' e dyke dhënë zën' e-mirë për mbretërin' e Perëndisë; edhe të dy-mbë-dhjetët' **ishinë** bashkë me atë, ² Edhe ca gra që ishinë shëruarë nga fryma të-këqia e nga smundje, Maria, që quhej Magdhalinë, prej së-cilësë patnë dalë shtatë djaj, ³ Edhe Joana e shoqeja

e Huzajt, kujdestarit të Irodhit, edhe Susanna, edhe shumë të-tjera, të-cilat' i shërbeninë me pasjen' e tyre.

⁴ Edhe si umbloth shumë gjindje, edhe vininë tek ay prej ç'do qyteti, foli me paravoli.

⁵ Dolli mbjellësi të mbillte farën' e ti; edhe ay tek po mbillte, ca ra përanë udhësë, edhe ushkel, edhe shpest' e qiellit e hëngrë. ⁶ Edhe tjtatërë ra mbi gur, edhe posa mbiu utha sepse nukë kishte lagësirë. ⁷ Edhe tjtatërë ra ndë mest të drizavet, edhe si mbinë drizatë bashkë me atë, e mbytnë. ⁸ Edhe tjtatërë ra mbë dhe të-mirë, edhe si mbiu, dha pemë për një një qint. Dyke thënë këto, thërriste, Kush ka veshë për të dëgjuarë letë dëgjonjë.

⁹ Edhe nxënësit' e ti e pyetninë, dyke thënë, Ç'do të jetë këjo paravoli? ¹⁰ Edhe ay tha, Juve u është dhënë të njihni fshetësit' e mbretëris' së Perëndisë; po të-tjerëvet me paravoli, që dyke dëgjuarë të mos kupëtonjë. ¹¹ Edhe paravolia është këjo:

Fara është fjal' e Perëndisë; ¹² Ajo përanë udhësë jan' ata që dëgjonjë; pastaj vjen djalli, edhe ngre fjalënë prej zëmërës' s'atyre, që të mos besonjë e të shpëtonjë. ¹³ Edhe ajo mbi gurt **jan' ata**, të-cilëtë, kur dëgjonjë, me gëzim e presënë fjalënë; po këta s'kanë rrënjë; sepse ata besonjë për ca kohë, po ndë kohë ngasjeje hiqenë lark. ¹⁴ Edhe ajo që ra ndër drizat, këta janë ata që dëgjuanë, po nga kujdesetë e nga pasja e nga kënaqjet' e **kësaj** jete shkonjë e mbytnë, e nukë bënë pemë. ¹⁵ Edhe ajo **që ra** ndë dhet të-mirë, këta jan' ata që dëgjuanë fjalënë, edhe e mbanjë ndë zëmërë të-mir' e të-qëruarë, edhe bënë pemë me durim.

¹⁶ Edhe asndonjë kur ndes kandile nuk' e mbulon me enë, a e vë ndënë shtrat; po e vë mbi kandiler, që të shohënë dritënë ata që hynjë. ¹⁷ Sepse nukë ka ndonjë të-fshehurë që nukë dotë çfaqetë; as të-fshehëtë që nukë dotë merretë vesh, e të dalë për faqe. ¹⁸ Vështroni pra qysh dëgjon; sepse ati që ka, dot' i epetë; po ati që s'ka, edhe ajo që pandeh se ka dotë merretë prej ati.

¹⁹ Edhe erdhë tek ay e ëma edhe të vëllezërit' e ti, edhe nukë muntninë për gjindjenë t'i afëroneshinë. ²⁰ Edhe i dhanë zë, dyke thënë, Jot' ëmë edhe t'ët vëllezër po rinë jashtë, edhe duanë të të shohënë. ²¹ Po ay përgjeq e u tha atyre, Mëmë e vëllezër më janë këta që dëgjonjë fjalënë edhe e bënë.

²² Edhe një ditë hyri ndë lundrë ay edhe nxënësit' e ti, edhe u tha atyre, Letë shkojmë nd' **anët** të-përtejme të lëqerit. ²³ Edhe lëshuanë. Edhe ata tek ishinë dyke lundruarë, e zuri gjumi. Edhe sbriti një thëllim ere ndë lëqert; edhe **lundra** po mbushej me ujë, edhe ishinë ndë rrezik. ²⁴ Edhe **ata** erdhë përan' ati, edhe e sgjuanë, dyke thënë, Mjeshtë, mjeshtë, po humbemi. Edhe ay ungrit e qërtoj erënë edhe valët' e ujit; edhe pushuanë, e ubë bunacë. ²⁵ Edhe u tha atyre, ku është besa juaj? Edhe **ata** ufrikësan' e uçuditnë, dyke thënë njëri tjtatërë, Vallë cili është ky që urdhëron edhe erërat' edhe ujëtë, edhe e ndigjonjë.

²⁶ Edhe me lundrënë arritnë ndë vëntt të gadharinëvet, që është përtej Galilësë.

²⁷ Edhe kur dolli mbë tokët, i dolli përpara një njeri prej qytetit, që kishte djaj prej shumë vjetëve, edhe rrobë nukë vishte, edhe ndë shtëpi nukë rrinte, po ndëpër varret. ²⁸ Edhe kur pa Jisunë, bërtiti e i ra ndër këmbë, e me zë të-math tha, ç'ke me mua, Jisu, i bir' i Perëndis' së-Lartë? të lutem, mos më mundo. ²⁹ Sepse **ay** urdhëroj frymën' e-ndyrë të dalë nga njeriu; sepse prej shumë vjetve e kishte rrëmbyerë, edhe lidhej me vargje, edhe ruhej me hekura këmbësh; po ay i këputte të-lidhuratë, edhe sillë prej djallit ndëpër shkretëtirat. ³⁰ Edhe Jisuj e pyeti, dyke thënë, Ç't'a **thonë** emërinë? Edhe ay i tha, Legjeon; sepse kishinë hyrë tek ay shumë djaj. ³¹ Edhe i luteshinë të mos i urdhëronte të shkoninë ndë pafundjet.

³² Edhe atje ishte një tuf' e madhe derrash dyke kulloturë ndë malt; edhe i luteshinë

t'i li j të hynjënë ndër ata; edhe **ay** i la. ³³ Edhe djajtë si duallë prej njeriut, hynë ndë derrat; edhe tuf' e derravet udruth prej shkëmbit ndë lëqert, edhe umbyt. ³⁴ Edhe kullotësitë kur panë se ç'ubë iknë; edhe van' e dhanë zë ndë qytett e ndëpër arat. ³⁵ Edhe duallë të shihninë se ç'ubë; edhe er-dhë te Jisuj, edhe e gjetnë njerinë, prej të-cilit kishinë dalë djajtë, dyke ndënjurë përanë këmbëvet të Jisujt, të-veshur' e të-urtësuarë; edhe ufrikësuanë. ³⁶ U treguan' edhe ata që e panë, qysh shpëtoj i-djallosuri.

³⁷ Edhe gjithë shumicë e vëndevet rrotullë Gadharinëvet i luteshinë të ikënjë nga ata, sepse i kishte zënë frik' e-madhe; edhe ay hyri ndë lundrët, e ukthye.

³⁸ Edhe njeriu, prej të-cilit kishinë dalë djajtë i lutej të jetë bashkë me atë; po Jisuj e lëshoj, dyke thënë, ³⁹ Kthehu ndë shtëpi t'ënde, edhe rrëfe **gjithë** sa bëri Perëndia mbë ty. Edhe ay shkoj dyke lëçiturë ndëpër gjithë qytetnë sa bëri Jisuj mb'atë.

⁴⁰ Edhe kur ukthye Jisuj, gjindja e priti **me gëzim**; sepse të-gjithë ishinë dyke pritur' atë.

⁴¹ Edhe ja tek erdhi një njeri që quhej Jair, (e, edhe ky ishte i-pari i sinagogjisë), e ra ndër këmbët të Jisujt, e i lutej të hynte ndë shtëpit t'ati; ⁴² Sepse kishte një bijë të-vetëmë, sindonja dy-më-dhjetë vjeç, edhe ajo po vdiste.

Edhe ay tek ishte dyke vaturë, gjindja po e shtrëngoninë. ⁴³ Edhe një grua, që kishte të-rrjedhurë gjaku dy-mbë-dhjetë vjet, e-cila kishte prishur gjithë gjënë ndëpër mjekësit, po nukë mundi të shëronej as prej ndonjëj, ⁴⁴ Uafërua së-rrapësmi, edhe preku pëqin' e rrobës' s'ati; edhe sa-kaqë-herash i undalua të-rrjedhurit' e gjakut. ⁴⁵ Edhe Jisuj tha, Kush qe ay që më preku? Edhe tek po mohoninë të-gjithë, Pjetri edhe ata që ishinë bashkë me atë thanë, Mjeshtë, gjindja të shtypnjen' e të shtrëngonjenë, edhe **Ti** thua, kush qe ay që më preku? ⁴⁶ po Jisuj tha, Dikush më preku, sepse unë mora vesh, se fuqi doli prej meje. ⁴⁷ Edhe gruaja kur pa se nuk' ufsheh **dot**, erdhi dyke dridhurë, edhe i ra ndër këmbë, e i rrëfeu përpara gjithë llauzit për ç'farë pune e preku, edhe se ushërua për-një-here, ⁴⁸ Edhe ay i tha asaj, kij zëmërë, bijë, besa jote të shpëtoj; hiq ndë paqtim.

⁴⁹ Edhe ay kur po fliste edhe, vjen një njeri prej të-parit të sinagogjisë, e i thotë, Se jot' bijë vdiq; mos e mundo mësonjësinë. ⁵⁰ Po Jisuj kur dëgjoj, upërgjeq, Mos kij frikë; veç beso, edhe dotë shpëtonjë. ⁵¹ Edhe si hyri ndë shtëpit, nukë la asnjë të hynte brënda, përveç Pjetrin' edhe Jakovin' edhe Joaninë, edhe t'an' e vashësë edhe t'ëmënë. ⁵² Edhe të-gjithë po qanin' e ulërininë për atë. Edhe ay tha, Mos qani; nukë vdiq, po po fle. ⁵³ Edhe e qeshninë, dyke diturë se vdiq. ⁵⁴ Po ay si nxori jashtë të-gjithë, e kapi prej dore, edhe thërriti dyke thënë, O vashëzë, ngreu. ⁵⁵ Edhe asaj i erdhi fryma rapë, edhe ungrit për-një-here; edhe **Jisuj** urdhëroj t'i epnin' asaj të hajë. ⁵⁶ Edhe prindërit' e asaj uhabitnë; po ay i porositi të mos i thonë njeriu se ç'ubë.

Krye 9

¹ Edhe **Jisuj** si thirri përanë të dy-mbë-dhjetë nxënësit e ti, u dha fuqi e pushtet mbi gjithë djajt, edhe të shëroninë smundje. ² Edhe i dëgjoj që të lëçisinë mbretërin' e Perëndisë, e të shëroninë të smurëtë. ³ Edhe u tha atyre, Mos mbani gjë udhësë, as stëpinj, as trajstë, as bukë, as ergjënt, as të kini nga dy **palë** rroba. ⁴ Edhe nd'atë shtëpi që të hyni, mbetuni atje, edhe delni andej, ⁵ Edhe sa **veta** që të mos u presënë juve, kur të delni prej ati qyteti, shkuntni edhe pluhurinë prej këmbëvet t'uaj, për dëshmi kundr' atyreve, ⁶ Edhe ata si duallë, shkoninë fshatravet, dyke dhënë zën' e-mirë, e dyke shëruarë tek do.

⁷ Edhe Irodhi katrurdhëratësi dëgjoj gjith' ato që bënëshinë prej ati; edhe manitej, sepse disa thoshinë, se Joani është ngjallurë prej së-vdekurish; ⁸ Edhe disa

thoshinë, se Ilija uduk; edhe të-tjerë, se është ngjallurë ndo një prej profitërvet të-moçim. ⁹Edhe Irodhi tha, Joanit un' i preva kryetë; po ky cili është, për të-cilinë dëgjon të-këilla punë? edhe kërkonte t'e shihte.

¹⁰Edhe apostojtë si ukthyenë i treguanë gjithë sa bënë; edhe **ay** i mori me vetëhe, edhe u hoq veçanë ndë një vënt të-shkretë të një qyteti që quhej Vithsaidha. ¹¹Edhe gjindja kur e kupëtuanë, i vanë pas; edhe **ay** si i priti, u fliste për mbretërin' e Perëndisë, edhe ata që kishinë nevojë shërimi i shëronte.

¹²Edhe dita zuri të thyhej; edhe të dy-mbë-dhjetët' erdhë përënë e i thanë, Lësho gjindjen të venë ndëpër fshatërat e ndëpër arat rrotullë, e të rrinë, e të gjenjënë të-ngrëna; sepse këtu jemi ndë vënt të-shkretë. ¹³Po **ay** u tha, Ep-u-ni ju atyreve të hanë. Edhe ata thanë, Ndër ne nukë gjëndenë më tepërë se pesë bukë edhe dy pishqë; veç ndë vafshimë na të blemë të-ngrëna për gjithë këtë llaus. ¹⁴Sepse ishinë sindonja pesë mijë burra. Edhe **ay** u tha nxënësve të ti, Vini ata të rrinë togje togje nga pesë-dhjetë. ¹⁵Edhe **ata** bënë kështu, edhe i vunë të-gjithë të rrinë. ¹⁶Edhe ay si mori të pesë bukëtë edhe të dy pishqetë, ngriti sytë ndë qiejt, edhe i bekoj, e i theu, edhe u'a dha nxënësve t'i vënë përpara gjindjesë. ¹⁷Edhe të-gjithë hëngrrë, e ungjinë; edhe ngritnë tepëricën' e copavet dy-mbë-dhjetë kofinë.

¹⁸Edhe ay tek falej veçanë, nxënësit' ishinë bashkë me atë; edhe i pyeti, dyke thënë, Cili thonë gjindja se jam unë? ¹⁹Edhe ata upërgjeqnë e thanë, Joan pagëzori; edhe të-tjerë, Ilija; edhe të-tjerë, se është ngjallurë ndonjë prej profitërvet të-moçim. ²⁰Edhe **ay** u tha atyre, Po ju cili thoni se jam unë? Edhe Pjetri upërgjeq e tha, Krishti i Perëndisë. ²¹Edhe ay i qërtoj e i porositi të mos j'a thonë njeriu këtë, ²²Dyke thënë se i Bir' i njeriut duhetë të heqë shumë, edhe nukë dotë pëlqenetë nga pleqt' e nga kryepfritërit' e nga shkronjësitë, edhe dotë vritetë, edhe të-tretënë ditë dotë ngjalletë.

²³Pastaj u thoshte të-gjithëve, Kush të dojë të vinjë prapa meje, letë mohonjë vetëhen' e ti edhe letë ngrerë kryqin' e ti përdita, edhe letë vinjë pas meje. ²⁴Sepse kush të dojë të shpëtonjë jetën' e ti, dot'a humpnjë; edhe kush të humpnjë jetën' e ti për mua, ky dot'a shpëtonjë. ²⁵Sepse ç'dobi ka njeriu, ndë fitoftë gjithë botënë, e të humpnjë vetëhen' e ti a t'a dëmtonjë? ²⁶Sepse kush të ketë turp për mua edhe për fjalët' e mia, edhe i Bir' i njeriut dotë ketë turp për këtë, kur të vinjë ndë lavdit të ti e të Atit e të ëngjëjvet të-shënjtëruarë. ²⁷Edhe po u them juve me të-vërtetë, **se** Janë ca prej këtyre që rrinë këtu, të-cilëtë nukë dotë ngjëronjë vdekje, gjersa të shohënë mbretërin' e Perëndisë.

²⁸Edhe pas këtyre fjalëve shkuanë sindonja tetë dit, edhe **ay** mori me vetëhe Pjetrin' e Joanin' e Jakovinë, edhe hipi ndë malt të falej. ²⁹Edhe tek falej i undërrua fytyr' e faqes' së ti edhe rrobat' e ti ishinë të-bardha edhe vetëtininë. ³⁰Edhe javoka dy burra tek po flisninë bashkë me atë, të-cilët' ishinë Moisiu edhe Ilija; ³¹Këta uduknë me lavdi, e thoshinë për vdekjen' e ati që kishte për të mbushurë ndë Jerusolim. ³²Po Pjetri edhe ata që ishinë bashkë me atë ishinë rënduarë nga gjumi; edhe kur usgjuanë, panë lavdin' e ati, edhe **ata** të dy burratë që rrinë bashkë me atë.

³³Edhe tek ndaheshin' ata prej ati, Pjetri i tha Jisujt, Mjeshtë, është mirë të jemi këtu; edhe letë bëjmë tri tenda, një për ty, e një për Moisinë, e një për Ilinë; pa diturë se ç'thoshte. ³⁴Edhe ay tek thoshte këto, erdhi një re, e i mbuloj me hie; edhe ata ufrikësuanë, kur hynë ndë ret. ³⁵Erdhi një zë nga qielli, dyke thënë, Ky është biri im i-dashuri; dëgjoni atë. ³⁶Edhe ndë të-ardhurit të zërit, Jisuj ugjënt vetëmë. Edhe s'bënë zë edhe asndonjë nuk' i thanë ato dit për ndonjë gjë nga ato që panë.

³⁷Edhe ditënë tjetërë, si sbrinë ata nga mali, shumë gjindje i dolli përpara.

³⁸Edhe na një njeri prej gjindjesë tek bërtiti, dyke thënë, Mësonjës, të lutem,

shtjerë sytë mbi t'im bir, se e kam të-vetëmë. ³⁹ Edhe na tek e kap **një** frymë, edhe bërtet papandehuraj, edhe e përpjek me shkumbë, edhe me zi ndahetë prej ati dyke dërmuar' atë. ⁴⁰ Edhe u luçë nxënëset të tu, që t'j'a nxjerrënë, po nukë muntinë. ⁴¹ Edhe Jisuj upërgjeq e tha, O bres i-pabesë e i-shtrëmbërë, gjer kur dotë jem me ju, edhe t'u duronj juve? bjerë t'ët bir këtu. ⁴² Edhe ay tek po vinte përënë, djalli e hodhi poshtë edhe e përpoqi. Edhe Jisuj e qërtoj frymën' e-ndyrë, edhe e shëroj djalënë, edhe j'a dha prapë t'et. ⁴³ Edhe të-gjithë maniteshinë për madhërin' e Perëndisë.

Edhe tek çuditëshinë të-gjithë për gjithë sa bëri Jisuj, u tha nxënëset të ti, ⁴⁴ Ju viri ndë veshët t'uaj këto fjalë; sepse i Bir' i njeriut dot' epetë ndër duart të njerëzet. ⁴⁵ Po ata nuk' e kupëtoninë këtë fjalë, edhe ishte e-fshehurë prej atyre që të mos e kupëtoninë; edhe kishinë frikë t'a pyetninë për këtë fjalë.

⁴⁶ Pastaj hyri një mendim ndër ata, cili vallë nga ata ishte më i-math. ⁴⁷ Edhe Jisuj kur pa mendimin' e atyre, zuri **prej dore** një çun, edhe e qëndroj përënë vetëhes' së ti, ⁴⁸ Edhe u tha atyre, Ay që të presë këtë çun mb'emërit t'im, mua më ka priturë; edhe ay që të presë mua, ka pritur' atë që më dërgoj; sepse ay që është më i-vogëlë ndër gjithë ju, ky dotë jetë më i-math.

⁴⁹ Edhe Joani upërgjeq e tha, Mjeshtë, pamë një njeri që nxjer djajtë mb'emërit t'ënt; edhe e ndaluamë, sepse nukë vjen pas bashkë me ne. ⁵⁰ Edhe Jisuj i tha, Mos e ndalni, sepse ay që s'është kundrë nesh, është bashkë me ne.

⁵¹ Edhe kur po mbusheshinë dittë që dotë merrej lart **ndë qiejt**, atëhere ay shtyri syn' e ti të vejë ndë Jerusolim. ⁵² Edhe dërgoj zë-dhënës përpara vetëhes' së ti, të-cilëtë van' e hynë ndë një fshat të Samaritëvet, për të bërë gati **vënt** për atë. ⁵³ Edhe nuk' e pritin' atë, sepse e kishte synë për të vaturë ndë Jerusolim. ⁵⁴ Edhe nxënësit' e ti Jakov e Joan kur panë, thanë, Zot, a do të themi të sbresë zjarr nga qielli edhe t'i përvëlönjë, sikundrë bëri edhe Ilija? ⁵⁵ Po ay ukthye e i qërtoj, edhe tha, Nukë dini e ç'farë frymë jini ju; ⁵⁶ Sepse i Bir' i njeriut nuk' erdhi të humpnjë shpirtë njerëzish, po të shpëtonjë. Edhe vanë mbë tjetërë fshat.

⁵⁷ Edhe ata kur po ecëninë, një njeri i tha udhësë, Zot, dotë të vinj pas kudo të veç. ⁵⁸ Edhe Jisuj i tha ati, Dhëpëratë kanë shtrofka, edhe shpest' e qiellit të-ndënjura; po i Bir' i njeriut s'ka ku të pshtetnjë kryetë.

⁵⁹ Edhe i tha një tjetëri, Eja pas meje. Edhe ay i tha, Zot, lër-më më përpara të vete e të kllas ndë dhet t'im atë. ⁶⁰ Po Jisuj i tha, Lërë të-vdekuritë të kllasënë ndë dhet të-vdekurit' e tyre; po ti ecë, e ep zë për mbretërin' e Perëndisë.

⁶¹ Po edhe një tjetërë tha, Zot, dotë vinj pas teje; po lërë-më më përpara të vete t'u lë shëndet atyre që janë ndë shtëpit t'ime. ⁶² Po Jisuj i tha, Kush vë dorën' e ti mbi parmëndë, edhe vështron prapa, nuk' është i-vëjyerë për mbretërin' e Perëndisë.

Krye 10

¹ Edhe paskëtaj Zoti vuri edhe të-tjerë shtatë-dhjetë **nxënës**, edhe i dërgoj dy nga dy përpara ti, mbë çdo qytet e vënt, ku kishte për të vatur' ay.

² U thoshte atyre pra, Të-korrët' **është** të-shumë, po punëtorëtë të-pakë; lutuni pra të zott të të-korrit të nxjerrë punëtorë për të-korrët' e ti. ³ Ecëni; na unë tek po u dërgonj juve posi shqera ndë mest të ujqërvet. ⁴ Mos mbani kuletë, as trajstë, as sholla; edhe asndonjë mos përshëndoshni udhësë.

⁵ Edhe nd'atë shtëpi që të hyni, më përpara thoni, Paqtim ndë këtë shtëpi. ⁶ Edhe ndë qoff' atje bir paqtimi, paqtimi juaj dotë prëhetë mb'atë; ndë mos, dotë kthenetë ndër ju. ⁷ Edhe mbetuni nd'atë shtëpi dyke ngrën' e dyke pirë nga ato që **t'u apënë juve** ata; sepse punëtori është i zot' i pagës' së ti, mos shkoni prej shtëpie mbë shtëpi.

⁸ Edhe nd'atë qytet që të hyni, edhe t'u presënë juve, hani ato që t'u vënë përpara, ⁹ Edhe shëroni të-smurëtë që **gjendenë** nd'atë, edhe thoni atyre, Mbretëri' e Perëndisë uafërua te ju. ¹⁰ Po nd'atë qytet që të hyni, edhe të mos u presënë juve, kur të delni ndëpër rugat, t'ati thoni, ¹¹ U shkuntmë juve edhe pluhurinë që na u ngjit prej qytetit t'uaj; po këtë të dini, se mbretëri' e Perëndisë uafërua te ju. ¹² Edhe po u thom juve, se nd'atë ditë më i-duruarshim dotë jetë mundimi ndë Sodhomat, se nd'atë qytet.

¹³ Mjerë ti Horazin! mjerë ti Vithsaidha! sepse po të ishinë bërë ndë Tyrët e ndë Sidhonët ato çudira që ubënë ndër ju, që kur dot' ishinë penduarë dyke ndënjurë ndë thes e ndë hi. ¹⁴ Po ndë Tyrët e ndë Sidhonët më i-duruarshim dotë jetë mundimi ndë **ditët** të gjyqit se mbë ju. ¹⁵ Edhe ti Kapernaum, që ulartësove gjer ndë qiellit, dotë sbreç gjer ndë hadht.

¹⁶ Ay që u dëgjon juve, dëgjon mua; edhe ay që nuk' u zë për gjë juve, nukë zë për gjë mua; edhe ay që nukë zë për gjë mua, nukë zë për gjë atë që më ka dërguarë.

¹⁷ Edhe të-shtatë-dhjetët' ukthyenë me gëzim, dyke thënë, Zot, edhe djajtë na dëgjonjënë mb'emërit t'ënt. ¹⁸ Edhe **ay** u tha atyre, Vështronjam Satanënë dyke rënë nga qielli posi vetëtimë. ¹⁹ Na tek po u ap juve pushtet që të shkelnj përmbi gjërpënj e përmbi përçollakë, edhe mbi gjithë fuqin' e armikut; edhe asndonjë gjë s'u ka për të bërë keq juve. ²⁰ Po mos ugëzoni për këtë, se undigjonjënë juve frymat' e-ndyra; po gëzohi më tepërë, se emëratë t'uaj ushkruajtnë ndë qiejt.

²¹ Edhe nd'atë orë Jisuj ugëzua ndë shpirt, edhe tha, Të falem ndersë, o Atë, Zot i qiellit edhe i dheut, se fsheve këto nga të-diturit' e nga të-mëncimitë, edhe u'a sbulove foshnjavet; po, o Atë, se kështu upëlqye përpara teje. ²² Të-gjitha m'udhanë ndë dorë prej t'im Et; edhe asndonjë nukë di cili është Biri, veç Ati; edhe cili është Ati, veç Biri, edhe ay, të-cilit të dojë biri t'j'a sbulonjë.

²³ Edhe ukthye te nxënësitë, e tha veçanë, Lum ata sy që shohënë këto që shihni. ²⁴ Sepse po u them juve, se shumë profitër edhe mbretër deshnë të shihnin' ato që shihni ju, po nuk' i panë; edhe të dëgjonin' ato që dëgjonin' ju, po nuk' i dëgjuanë.

²⁵ Edhe na tek ungrit një nomtar, dyke ngar' atë, e dyke thënë, Mësonjës, ç'të bënj, që të trashëgonj jetën e-përtjetëshme? ²⁶ Edhe ay i tha, Ç'është shkruarë ndë nomt; qysh këndon? ²⁷ Edhe ay upërgjeq e tha, "Të duash Zonë Perëndinë t'ënt me gjithë zëmërë t'ënde, edhe me gjithë shpirtinë t'ënt, edhe me gjithë fuqinë t'ënde, edhe me gjithë mëndjenë t'ënde." ²⁸ Edhe ay i tha, upërgjegje drejtë; bëj këtë, edhe dotë ronjë. ²⁹ Po ay, dyke dashurë të nxjerrë vetëhen' e ti të-drejtë, i tha Jisujt, E cili më është i-afërm?

³⁰ Edhe Jisuj upërgjeq e tha, Një njeri sbriste nga Jerusalmi ndë Jeriho edhe ra ndër duar kursarësh; të-cilëtë si e sveshnë, edh' e bënë me plagë, ikn' edhe e lanë për gjysmë të-vdekurë. ³¹ Edhe qëlloj të shkonj' asaj udhe një prift; edhe kur pa atë, shkoj nga ana tjetërë. ³² Kështu edhe një Levit, posa arriti nd'**atë** vent, erdhi e pa, edhe shkoj nga ana tjetërë. ³³ Po **një** Samarit, dyke udhëtuarë, erdhi ndë vëntt, tek ishte **ay**, edhe kur e pa, i udhëmp; ³⁴ Edhe erdhi përënë, e i lidhi plagëtë, dyke derdhurë **mbi ato** vaj e verë; edhe e hipi ndë kafshët të ti, edhe e solli ndë një huajpritje, edhe ukujdes për atë. ³⁵ Edhe mbë të-nesërmet kur dotë dilte, nxori dy dinare, edhe j'a dha huajpřitësit, edhe i tha, Kujdesu për këtë njeri; edhe ç'të prishç më tepërë, unë, kur të kthenem, t'i kam për të dhënë. ³⁶ Cili nga këta të tre të duketë se ubë i-afërm' i ati që ra ndë duart të kursarëvet? ³⁷ Edhe ay i tha, ay që bëri përdëllim mb'atë. Jisuj pra i tha, Ecë, edhe ti bëj kështu.

³⁸ Edhe ata kur po shkoninë, ay hyri ndë një fshat; edhe një grua **që e kishte** emërinë Marthë, e priti atë ndë shtëpi të saj. ³⁹ Edhe ajo kish një motërë që

quhej Marie, e-cila ndëni për anë këmbëve të Jisujt, edhe dëgjonte fjalën e ati.
⁴⁰ Edhe Martha mundonej shumë dyke shërbyerë; edhe pastaj erdhi përpara ati, e tha, Zot, nukë dotë dish, se ime motrë më la vetëmë të shërbenj? thuaj pra asaj të më ndihnjë. ⁴¹ Edhe Jisujt upërgjeq e i tha asaj, Marthe, Marthe, përpqesh e mundonesh për shumë **punë**; ⁴² Po për një është nevojë; edhe Maria sgjodhi pjesën e mirë, e-cila nukë dotë merretë prej asaj.

Krye 11

¹ Edhe ay tek po falej ndë një vënt, si pushoj, një nga nxënësit e ti i tha, Mëso-na të falemi, sikundrë edhe Joani nxënësit e ti.

² Edhe ay u tha atyre, kur të faleni, thoni,

Ati ynë që **je** ndë qiejt, ushënjtëroftë emëri yt; arthtë mbretëria jote; ubëftë dashurimi yt, si ndë qiell, edhe mbi dhet. ³ Bukënë t'ënë të-përditëshmen' ep-na neve përdita; ⁴ Edhe fal-na fajetë t'anë, sepse edhe neve j'a falmë kujdo që na fëjën; edhe mos na shtjerë ndë ngasje, po shpëto-na prej të-ligut.

⁵ Pastaj utha atyre, Cili prej jush, ndë pastë një mik, edhe të vejë tek ay ndë mest të natësë, e t'i thotë, Mik, huaj-më tri bukë; ⁶ Sepse erdhi një miku im prej udhësë tek unë, edhe s'kam ç't'i vë përpara; ⁷ Edhe ay të përgjigjetë që brënda e t'i thotë, Mos më ep mundim; dera tashi është mbyllurë, edhe çunat' e mi janë ndë shtrat bashkë me mua; S'munt të ngrihem e të t'ap? ⁸ Po u them juve, Edhe ndë mos ungrittë e t'i apë, sepse është miku i ati, për të-mosturpëruarët' e ati dotë ngrihet' e dot'i apë sa i duhenë. ⁹ Edhe unë po u them juve, Lypni, edhe dot'u epetë juve; kërkoni, edhe dotë gjeni; trokollini, edhe dot'u hapetë juve. ¹⁰ Sepse kushdo që lypën merr; edhe ay që kërkon gjen; edhe ati që trokëllin dot'i hapetë.

¹¹ Edhe ndë **është** ndonjë prej jush atë, edhe i biri ndë i kërkotë bukë, mos dot'i apë gur? a po ndë **i lypëtë** peshk, mos dot'i apë gjarpër ndë vëntt të peshkut?

¹² Apo ndë i kërkotë ve, mos dot'i apë përçollak? ¹³ Ndë ju pra që jini të-liq dini t'u epni bijvet t'uaj të-dhëna të-mira, sa më tepërë Ati që **është** prej qielli dot'u apë Frymë të-Shënjtëruarë atyre që të lypnjënë prej ati?

¹⁴ Edhe ishte dyke nxjerë një djall, edhe ay ishte i-shurdhërë; edhe djalli kur doli, i-shurdhëri foli; edhe gjindja uçuditnë. ¹⁵ Po ca nga ata thanë, **Se** nxjer djajtë me anë të Veelizevulit, të-parit të djajvet. ¹⁶ Edhe ca të-tjerë dyke ngar' atë kërkoninë prej ati Shënjë nga qielli. ¹⁷ Po ay si kupëtoj mendimet' e atyre, u tha, Çdo mbretëri, që ndahetë kundrë vetëhes' së saj, shkretonetë; edhe një shtëpi, **që** ndahetë kundrë vetëhes' së saj, rrëzonetë. ¹⁸ Edhe Satanaj pra ndë qoftë se unda kundrë vetëhes' së ti, qysh dotë qëndronjë mbretëri' e ati? sepse thoni se unë nxjer djajtë me anë të Veelizevulit. ¹⁹ Edhe ndë nxjer unë djajtë me anë të Veelizevulit, bijtë t'uaj me anë të cilit i nxjernjënë? për andaj ata dotë jenë gjykatësitë t'uaj.

²⁰ Po ndë nxjer **unë** djajtë me gishtin e Perëndisë, pa fjalë mbretëri' e Perëndisë ariu mbë ju. ²¹ I-forti kur ruan i-armatosurë avllin' e ti, **gjithë** gjëj' e ati është ndë paqtim; ²² Po kur vjen m'i-forti se ay e munt, i mer gjithë armët' e ati, mbë të-cilat shprente, edhe ndan plaçkat' e ati, ²³ Kush nuk' është me mua, është kundrë meje; edhe kush nukë përmbledh bashkë me mua, përdan. ²⁴ Frym' e-ndyrë kur del prej njeriut, vete ndëpër vënde të-thatë, pa **ujë**, edhe kërkon të-prëjturë; edhe dyke mos gjeturë, thotë, Le të kthenem ndë shtëpit t'ime, prej së-cilësë dolla. ²⁵ Edhe kur vjen, e gjen fshir' e stolisurë. ²⁶ Atëhere vete e merr me vetëhe shtatë fryma të-tjera më të-këqia se vetëhen' e saj, edhe hynjën' e rrin' atje; edhe të-pastajmet' e ati njeriu bënë më të-këqia se të-paratë.

²⁷ Edhe ay kur po thoshte këto, një grua prej gjindjesë ngriti zë e i tha, Lum barku që të ka mbajturë, edhe gjithë që ke thëthiturë. ²⁸ Po ky tha, Lum më tepërë ata që dëgjonjënë fjalën' e Perëndisë edhe e ruanjënë.

²⁹ Edhe gjindja tek po mblidhej, zuri të thotë, ky bres është i keq; shënjë kërkon; edhe shënjë nukë dot'i epetë përveç shënjës së profitit Jona. ³⁰ Sepse sikundër Jonaj ubë shënjë ndë Ninevitët, kështu edhe i Bir' i njeriut do të jetë ndë këtë bres.

³¹ Mbretëresh' e mesditësë do të ngrihetë ndë **ditët të** gjyqit bashkë me njerëzit' e këti brezi, edhe dot'i dënonjë; sepse erdhi nga anët' e të-mbaruarit të dheut që të dëgjonjë urtësin' e Sollomonit; edhe na këtu **ka** më tepërë se Sollomoni. ³² Burrat' e Ninevisë dotë ngjallënë ndë gjyq bashkë me këtë bres, edhe dot' e dënonjë; sepse upenduanë ndë të lëçiturit të Jonajt; edhe na këtu **ka** më tepërë se Jonaj.

³³ Edhe as ndonjë, kur ndes kandile nuk' e vë **ndë vënt** të fshehurë, as ndënë shënikt, po **e ve** mbi kandiliert, që të shohënë dritënë ata që hynjë në brënda.

³⁴ Kandil' i trupit është syri; syri yt pra kur është i qëruarë, edhe gjithë trupi yt është i-ndriturë; po kur' është i-keq, edhe trupi yt **është'** i-errëtë. ³⁵ Vështro pra drita që është te ti se mos jetë errësirë. ³⁶ Ndë qoftë pra gjithë trupi yt i-ndriturë, pa pasurë ndonjë anë t'errëtë, dotë jetë i-tër' i-ndriturë, posi kandileja kur të ndrit me dritën' e saj të-fortë.

³⁷ Edhe si foli **këto** një Farise i lutej ati të vejë për drekë tek ay; edhe **ay** hyri e ndënji ndë mësalët.

³⁸ Edhe Fariseu uçudit, kur pa, se nuk' u la përpara drekësë. ³⁹ Edhe Zoti i tha, Tashi ju Farisenjtë qëroni të-përjashtësmen' e qeffit e të kupësë; po e-përbrëndëshmja juaj është plot me rrëmbim e me të-keq. ⁴⁰ Të-marrë, ay që bëri tëpërjashtësmenë, a nukë bëri edhe të-përbrëndëshmenë? ⁴¹ Veç epni eleimosinë gjënë **t'uaj**, edhe na të-gjitha tek janë të-qëruara te ju. ⁴² Po mjerë ju Farisenjtë! sepse epni të-dhjetën' e mëndres' e të piganit e të çdo lakre, edhe lino mbë nj'anë gjyqin' e dashurin' e Perëndisë. Këto duhej të bënitë, edhe ato të mos i linitë. ⁴³ Mjerë ju Farisenjtë! sepse doni vëndin' e-parë ndëpër sinagogjit, edhe të-përshëndoshuratë ndëpër tregjet. ⁴⁴ Mjerë ju shkronjë e Farisenj, ipokritë, se jini po si varretë që s'dukenë, edhe njerëzitë që ecëjnë përsipërë nukë dinë.

⁴⁵ Edhe një nga nomtarëtë upërgjeq e i tha, Mësonjë, dyke thënë këto shan edhe neve, ⁴⁶ Edhe ay tha, Mjerë edhe ju nomtarëtë! sepse ngarkoni njerëzitë me barrë të-rënda që s'mbahenë, edhe ju **as** me njërin' e gishtërvet' t'uaj nuk' i prekni barrëtë. ⁴⁷ Mjerë ju! sepse ndërtoni varret' e profitërvet, edhe atëritë t'uaj i vranë, ⁴⁸ Me të vërtetë dëshmoni edhe pëlqeni punët' e atërvet' t'uaj; sepse ata i vranë, edhe ju ndërtoni varret' e atyreve. ⁴⁹ Do të dërgonj ndër ata profitë e apostoj, edhe **disa** prej atyreve dot'i vrasënë, edhe dot'i ndjekënë; ⁵⁰ Që të kërkonetë prej këti brezi gjaku i gjithë profitërvet që është derdhurë që kur se është ngrehurë bota, që prej gjakut t'Avelit **e** gjer mbë gjakt të Zaharisë, ⁵¹ Që uvra ndë mest të therores' e të tempullit; vërtet, po u them juve, dotë kërkonetë prej këti brezi. ⁵² Mjerë ju nomtarëtë! sepse ngrittë hapësin' e dijtësë; ju nukë hytë, po edhe ata që hynjë në ndaluatë.

⁵³ Edhe ay tek u thoshte atyre këto, shkronjësit' edhe Farisenjtë zunë t'a ndisninë tepërë, edhe t'a shtrëngoninë të fliste për shumë **punë**. ⁵⁴ Sepse kishinë ngrehurë lak për atë, edhe kërkoninë të rëmbeninë ndonjë fjalë prej gojës' s'ati, që ta përflasënë.

Krye 12

¹ Ndë mest të këtyre **fjalëve**, si umblohnë shumicat' e gjindjesë, kaqë sa shkëlninë njëri tjetërinë, zuri t'u thoshte nxënëset të ti, Më parë **nga gjithë** ruani vetëhenë t'uaj nga brum' i Farisenjet, që është ipokrisi. ² Po nukë ka gjë të-mbuluarë, që s'është për të sbuluarë, edhe të-fshehurë, që s'është për të marrë vesh. ³ Përandaj sa thatë nd'errësirët, dotë dëgjonënë ndë dritët; edhe ç'foltë ndë vesht ndëpër dhomat, dotë lëçitetë mbi kulmet **të-shtëpivet**.

⁴ Edhe po u them juve miqvet të mi, Mos kini frikë nga ata që vrasënë trupnë, edhe pastaj s'kanë se ç'të bëjnë gjë më tepërë. ⁵ Po dot'u dëftenj juve prej cilit të kini frikë; të kini frikë prej ati, i-cili passi të vrasë, ka pushtet të hedhë ndë gjehenët. Me të-vërtetë po u them juve, prej këti të kini frikë. ⁶ A nukë shitenë pesë zoq për dy aspre? edhe një nga ata nuk' është i-harruarë përpara Perëndisë; ⁷ Po edhe qimet' e kresë s'uaj janë numëruarë të-gjitha. Mos kini frikë pra; ju ndani prej shumë zoqsh.

⁸ Edhe po u them juve, Kushdo që të më rrëfenjë përpara njerësvet, edhe i Bir' i Perëndisë dot' e rrëfenjë përpara ëngjëjvet të Perëndisë. ⁹ Edhe kushdo që të më mohonjë përpara njerësvet, dotë mohonetë përpara ëngjëjvet të Perëndisë.

¹⁰ Edhe kushdo që të thotë fjalë kundrë të Birit të njeriut, dot'i faletë; po ai që të shanjë kundrë Frymës' së-shënjtëuarë nukë dot'i faletë.

¹¹ Edhe kur t'u sjellënë juve ndëpër sinagogjit, e **ndëpër** urdhëratat, e **ndëpër** pushtetet, mos mendoni qysh a ç'të përgjigji, a ç'të thoni; ¹² Sepse Frym' e-Shënjtëuarë dot'u mësonjë juve nd'atë orë ç'duhet të thoni.

¹³ Edhe një prej gjindjesë i tha, Mësonjës, thuaj t'im vëllaj të ndanjë trashëgimnë bashkë me mua. ¹⁴ Po ay i tha, O njeri, kush më vuri gjykatës a ndanjës mbi ju?

¹⁵ Pastaj u tha atyre, Vështroni edhe ruhi nga lakmimi; Sepse ndë pastë tepërë ndonjë, jet' e ati nukë është bërë prej gjës' s'ati.

¹⁶ Edhe u tha atyre një paravoli, dyke thënë, Një njeriu të-pasurë i erdhë mbarë aratë; ¹⁷ Edhe mendonej ndë vetëhet të ti, dyke thënë, Ç'të bënj? se s'kam ku të mbleth pemët e mia. ¹⁸ Pastaj tha, Këtë kam për të bërë; dotë prish grunarët' e mi, edhe dot'i bënj më të-mëdhenj, edhe dotë mbleth atje gjithë drithëtë t'im, edhe të-mirat' e mia; ¹⁹ Edhe dot'i them shpirtit t'im, O shpirt, ke shumë të-mira që gjendenë për shumë vjet; prëhu, e ha, e pi, e gëzohu. ²⁰ Po Perëndia i tha, I-marrë, këtë natë dotë lypnënjë prej teje shpirtinë t'ënt; edhe sa bëre gati, të kujt dotë jenë? ²¹ Kështu dotë jetë ay që mbleth thesarë për vetëhen' e ti, e nuk' bënetë i-pasurë mbë Perëndinë.

²² Pastaj u tha nxënësvet të ti, Përandaj po u them juve, Mos kini kujdes për jetënë t'uaj, ç'të hani; as për trupnë t'uaj, ç'të vishni. ²³ Jeta është më e-vyerë se ushqimi, edhe trupi se të-veshuritë. ²⁴ Viri re korbatë, as nukë mbjellënë, as nukë korrnënjë; ata nukë kanë as qilar as grunar, edhe Perëndia i ushqen; sa më tepërë ndani ju nga shpestë? ²⁵ Edhe cili prej jush dyke pasurë kujdes munt të shtonjë një kut ndë shtatt të ti? ²⁶ Ndë **ju** pra nukë muntni as më të-vogëlënë **gjë**, përse kini kujdes për të-tjeratë? ²⁷ Viri re luletë, qysh rritenë; nukë mundonenë, as nukë drethnënjë; edhe po u them juve, **se** as Sollomoni me gjithë lavdin' e ti nuk' ishte veshurë si një nga këto. ²⁸ Po ndë qoftë se barinë, që sot është nd'arë, edhe nesërë hidhetë ndë furrë, Perëndia e vesh kështu, sa më tepërë juve, o besë-pakë?

²⁹ Edhe ju mos kërkoni ç'të hani a ç'të pini; as mos jini me dy mëndje. ³⁰ Sepse gjithë këto kërkonjënjë kombet' e botësë; edhe Ati uaj e di, se keni nevojë për këto. ³¹ Po kërkoni mbretërin' e Perëndisë, edhe këto të-gjitha dot'u shtonenë juve.

³² Mos ki frikë, o tuf' e-vogëlë; sepse Atit t'uaj i pëlqeu t'ua apë juve mbretërinë.

³³ Shitni pasjetë t'uaj, edhe epni eleimosinë. Bëni për vetëhenë t'uaj kuleta që nukë vjetëronenë, thesar ndë qiejt që nukë shteretë, atje ku kursari nuk' afëronetë, as krimbi nukë prish. ³⁴ Sepse ku është thesari juaj, atje dotë jetë edhe zëmëra juaj. ³⁵ Letë jenë mezetë t'uaj ngjeshurë, edhe kandiletë ndezurë; ³⁶ Edhe ju **jini gati** posi njerës që presënë të zon' e tyre, kur dotë kthenetë nga dasma, që, kur të vinj' e të trokëllinjë, për-një-here t'i hapnënjë. ³⁷ Lum ata shërbëtorë, të-cilëtë, kur të vinj' i zoti, dot'i gjenjë sgjuarë; vërtet po u them juve, se dotë ngjishetë, e dot'i vërë të rrinë ndë mësallët, edhe dotë vinjë përënanë e dot'u shërbënjë atyre.

³⁸ Edhe nd'arthtë ndë të-dytënë ruajtje, edhe ndë të-tretënë ruajtje ndë arthtë, edhe

t'i gjenjë kështu, të-lumurë jan' ata shërbëtorë. ³⁹ Edhe këtë e dini, se, po t'e dinte i zot' i shtëpisë, mbë ç'orë vjen kursari, dotë rrinte sgjuarë, edhe nukë dotë linte t'i çponej shtëpia. ⁴⁰ Edhe ju pra bëhi gati; sepse i bir' i njeriut vjen nd'atë orë që nuk' e mendoni.

⁴¹ Atëhere Pjetri i tha, Zot, për neve e thua këtë paravoli, apo për të-gjithë.

⁴² Edhe Zoti tha, Vallë cili është ay kujdestar besëtar edhe i-mënçim, të-cilinë dot'a vërë i zoti mbi shërbëtorët' e ti, që t'u apë mbë kohë ushqimin' e-ndarë **për sicilinë**. ⁴³ Lum ay shërbëtuar, të-cilinë, kur të vinj' i zoti, dot'e gjenjë dyke bërë kështu. ⁴⁴ Vërtet po u them juve se e ka për të vënë mbi gjithë gjën' e ti. ⁴⁵ Po ndë thënt' ay shërbëtuar ndë zëmëret të ti, **se** Im Zot mënon të vinjë; edhe të zërë të rrahë shërbëtorët' e shërbëtoretë, e të hajë e të pijë e të dehetë; ⁴⁶ I zot' i ati shërbëtori dotë vinj' atë ditë që s'e pret, edhe atë orë që s'e di; edhe dot'e ndanjë, edhe dot'e vërë pjesën' e ati bashkë me të-pabesëtë. ⁴⁷ Edhe ay shërbëtuar që e dinte andën' e të Zotit, edhe nukë bëri gati, as nukë bëri sipas andës' s'ati, dotë rrihetë shumë. ⁴⁸ Po ay që nuk' e diti, edhe bëri punë për të rrahurë, dotë rrihetë pak. Edhe gjithë-kujt që i udha shumë, shumë dotë kërkonetë prej ati; edhe ati që i ulëshuanë shumë, më shumë dotë lypnjënë prej ati.

⁴⁹ Erdha të vë zjar mbë dhet; edhe ç'**tjetërë** dua, ndë qoftë se undes tashi?

⁵⁰ Edhe kam një pagëzim të pagëzonom, edhe sa shtrëngonem gjersa të mbaronetë? ⁵¹ Pandehni, se kam ardhurë t'ap paqtim mbë dhet? jo, po u them juve, po ndarje. ⁵² Sepse që tashi e paskëtaj pesë vetë ndë një shtëpi dotë jenë të ndarë **ndë mest të tyre**, tre kundrë dyve, edhe dy kundrë treve. ⁵³ Dotë ndahetë i ati kundrë të birit, edhe i biri kundrë t'et; e ëma kundrë së bijësë, edhe e bija kundrë s'ëmësë; vjehërra kundrë nuses' së saj, edhe nusja kundrë së vjehërrësë.

⁵⁴ I thoshte edhe gjindjesë, Kur shihni renë se del prej perëndimit, për-një-here thoni, Po vjen shi; edhe bënë të kështu; ⁵⁵ Edhe kur **shihni**, se fryn erë mesdite, thoni, Se dotë bënë vapë; edhe bën. ⁵⁶ Ipokritër, faqen' e dheut e të qiellit dini t'e shquani; po këtë kohë si nuk' e shquani?

⁵⁷ Edhe si nukë gjykoni edhe prej vetëhesë s'uaj të drejtënë? ⁵⁸ Kur vete pra tek urdhëratësi bashkë me kundrëgjyqësinë t'ënt, përpigu udhësë të shpëtonjç prej ati, semos të heqë të gjykatësi, edhe gjykatësi të apë ndë dorët të shërbëtorit, edhe shërbëtori të hedhë ndë burk. ⁵⁹ Po të them tyj, Nukë ke për të dalë andej, gjersa të lajsh edhe asprën' e fundit.

Krye 13

¹ Edhe nd'atë kohë ishin' atje përpara disa **veta** dyke dëftyer' ati për Galileanëtë, gjaknë e të cilëvet Pillati e përzjeu bashkë me kurbanet' e tyre. ² Edhe Jisuj upërgjeq e u tha atyre, Pandehni, se këta Galileanë ishin më fajtorë se gjithë Galileanëtë, sepse pësuantë të-këtitilla **punë**? ³ Jo, po u them juve; po ndë mos u-pendofshi, të-gjithë kështu kini për të humburë. ⁴ Apo ata të tetë-mbë-dhjetëtë; mbi të-cilët ra pirlu ndë Siloam, edhe i vrau, pandehni, se këta ishinë fajtorë më tepërë se gjithë njerëzitë që rrinë ndë Jerusalem? ⁵ Jo, po u them juve; po ndë mos upendofshi, kështu të-gjithë kini për të humburë.

⁶ Edhe thoshte këtë paravoli: Një njeri kishte mbjellë një dru fiku ndë vreshtët të ti; edhe erdhi të marë pemë prej ati, po nukë gjeti. ⁷ Edhe i tha Vreshtarit, Na tek po vinj tre vjet të marr pemë prej këti druri të fikut, edhe nukë gjenj; pre-e; përse të zërë edhe vëdinë mbë kot? ⁸ Po ay upërgjeq e i tha, zot, lër-e edhe këtë mot, gjersa të rëmih rrotull' ati, e t'i shtie plehë; ⁹ Edhe ndë bëftë pemë, **mirë**; po ndë mos **bëftë**, dot'e preç pastaj.

¹⁰ Edhe një të-shëtunë ishte dyke mësuarë **njerëzitë** ndë një sinagogji; ¹¹ Edhe ja një grua që kishte frymë smundjeje tetë-mbë-dhjetë vjet, edhe ishte kurusurë,

e nukë muntte asfare të ngrihej përpjetë. ¹² Edhe Jisuj kur e pa, e thirri, edhe i tha, Grua, e-liruarë je prej smundjesë s'ate. ¹³ Edhe vuri duartë mbi atë, edhe ajo për-një-herë udrejtua, edhe lavduronte Perëndinë.

¹⁴ Po i-par' i sinagogjisë upërgjeq me zëmërim, sepse Jisuj **ditën'** e-shëtunë e shëroj, e i thoshte gjindjesë, Gjashtë dit janë, ndë të-cilatë duhetë të punoni; ndë këto pra ejani e shërohi, e jo ditën' e-shëtunë. ¹⁵ Zoti pra upërgjeq e i tha, Ipokrit, gjithë-sicili prej jush ditën' e-shëtunë a nukë s'gjith kan' e ti, a gomarin' e ti nga grashti, edh' e sjell e i ep ujë? ¹⁶ Edhe këjo që është' e bij e Avraamid, të-cilënë na tek e pat lidhurë Satanaj tetë-mbë-dhjetë vjet, a nukë duhej të sgidhej prej këti të-lidhuri ditën' e-shëtunë?

¹⁷ Edhe ay tek po thoshte këto, gjith' ata që i dilninë kundër turpëroneshinë; edhe gjithë gjindja gëzonej për gjithë punët' e-lavduruarshimë që bëneshinë prej ati.

¹⁸ Edhe **ay** thoshte, Me se përgjan mbretëri' e Perëndisë? edhe me se t'a përgjanj? ¹⁹ Përgjan me një koqe sinapi, të-cilën' e mori një njeri edhe e hodhi ndë kopshtët të ti; edhe urrit, e ubë dru i-math, edhe shpest' e qiellit erdh'e bënë të-ndënjura ndë degat t'ati.

²⁰ Edhe përsëri tha, Me se t'a përgjanj mbretërin' e Perëndisë? ²¹ Përgjan me brumë, të cilin' e mori një grua, edhe e fshehu ndë tri masa mjelli, gjersa umbruajt gjithë.

²² Edhe shkonte ndëpër qytete e ndëpër fshatëra dyke mësuarë, edhe dyke bërë udhë për ndë Jerusalem.

²³ Edhe një njeri i tha, Zot, vallë të-pakë **jan'** ata që shpëtonjënë? ²⁴ Edhe ay u tha atyre, Mundohuni të hyni ndëpër derët të-ngushtë; sepse shumë **veta**, po u them juve, dotë kërkonjënë të hynjënë, edhe nukë dotë muntjnënë. ²⁵ Passi të ngrihet' i zot' i shtëpisë, e të mbyllnjë derënë, atëhere dotë zini të rrii jashtë, e të trokëllini ndë derët, dyke thënë, Zot, Zot, hap-na; edhe ay dotë përgjigjet' e dot' u thotë juve, Nuk' u di juve se nga jini; ²⁶ Atëhere dotë zini të thoni, Hëngrem' e pimë përpara teje, edhe mësove ndëpër rrugat t'ona. ²⁷ Po ay dotë thotë, Po u them juve, nuk' u di juve se nga jini; ikëni prej meje gjithë ju punëtorët' e paudhësisë.

²⁸ Atje dotë jetë të-qarët' e të-kërcëlliturit' e dhëmbëvet, kur të shihni Avraamin' e Isaakun' e Jakovin' e gjithë profitëritë ndë mbretërit të Perëndisë, edhe vetëhenë t'uaj të-nxjerrë jashtë. ²⁹ Edhe dotë vinjënë nga lindja e nga perëndimi, e nga an' e borës' e nga an' e shiut, edhe dotë **unjenë të** rrinë ndë mbretërit të Perëndisë.

³⁰ Edhe na tek janë të-prapësm që dotë jenë të-parë, edhe të-parë që dotë jenë të-prapësm.

³¹ Atë ditë erdhë disa Farisenj, dyke thën' ati, Dil e ikë së-këtejmi, sepse Irodhi do të të vrasë. ³² Edhe ay u tha atyre, Hiqni e i thoni kësaj dhelpëre, Na tek nxjer djaj, edhe bënj shërime sot edhe nesërë, edhe të-tretënë **ditë** dotë mbaronem.

³³ Po unë duhetë sot edhe nesërë edhe tjetrënë ditë të vete; sepse nuk' është' gjë e-mundurë profit të prishetë jashtë Jerusalem. ³⁴ Jerusalem, Jerusalem, që vret profitëritë edhe rreh me gurë ata që janë dërguarë të ti, sa herë kam dashurë të mbleth djemt' e tu, posi pula zoq' e saj ndënë krahët, edhe nukë deshtë! ³⁵ Na shtëpia juaj tek po u lihetë (e-shkretë). Edhe me të vërtetë po u them juve, se nukë dotë më shihni gjersa të vinjë **koha**, kur të thoni, I-bekuarë **është'** ay që vjen mb'emërit të Zotit.

Krye 14

¹ Edhe një ditë të-shëtunë, kur erdhi ay ndë shtëpit të njëj nga të-parët' e Farisenjvet për të ngrënë bukë, ata ishinë dyke vënë re atë.

² Edhe ja një i-idhropikasurë tek ishte përpara ati. ³ Edhe Jisuj upërgjeq e u tha nomtarëvet edhe Farisenjvet, dyke thënë, A është' e udhësë **njeriu** të shëronjë

ditën' e-shëtunë? ⁴ Edhe ata nukë bënë zë. Atëherë **ay** e zuri edhe e shëroj, edhe e lëshoj. ⁵ Pastaj upërgjeq e u tha atyre, Kujt prej jush t'i bjerë gomari a kau ndë pus, edhe nuk' e nxjerrë sa-kaqë-herash ditën' e-shëtune? ⁶ Edhe ata nukë muntë t'i përgjigjeshinë mbë këto **fjalë**.

⁷ Edhe atyreve që ishinë ftuarë u thoshte një paravoli, (sepse vinte re, qysh s gjithinë vëndet' e-parë,) dyke thënë atyreve, ⁸ Kur të ftonesh nga ndonjë ndë dasmë, mos rri ndë kryet të mësallësë, semos është ftuarë prej ati ndonjë **tjetërë** m'i-nderçim se ti, ⁹ Edhe vjen ay që ka ftuarë ty edhe atë, e të thotë, Ep-i vëdinë këtij; edhe atëhere dotë zësh me turp të rrish ndë vëntt të fundit. ¹⁰ Po kur të ftonesh, shko e rri ndë vëntt të fundit, që, kur të vinj' ay që të ka ftuarë, të të thotë, Mik, hipë më sipërë. Atëhere dotë jetë lavdim për ty përpara atyreve që rrinë ndë mësallë bashkë me ty. ¹¹ Sepse kushdo që ngre lart vetëhen' e ti dotë përunjëtë, edhe ay që përunj vetëhen' e ti dotë ngrihetë lart.

¹² I thoshte edhe ati që e kishte ftuarë, kur të bënëj drek' a darkë, mos thirrë miqt' e tu, as vëllezërit' e tu, as njerëzit' e tu, as fqinj të-pasurë; semos të thërresënë rapë dhe ata, edhe bënëjtë çpagim mbë ty. ¹³ Po kur të bënëj gosti, thirrë të-vobeq, ulokë, të-çalë, të-verbërë; ¹⁴ Edhe dotë jesh i-lumurë; Sepse ata nukë kanë të t'a çpaganjënë; edhe dotë të çpaguhetë ndë ngjalljet të të-drejtëvet.

¹⁵ Edhe një nga ata që kishinë ndënjurë bashkë ndë mësallët, kur dëgjoj këto fjalë, i tha, Lum ay që të hajë bukë ndë mbretërit të Perëndisë. ¹⁶ Edhe ay i tha ati,

Një njeri bëri një darkë të-madhe, edhe ftoj shumë **veta**; ¹⁷ Edhe ndë kohët të darkësë dërroj shërbëtorin' e ti që t'u thoshte atyreve që ishinë ftuarë. Ejani, se tashti të-gjitha janë gati. ¹⁸ Po të-gjithë zunë si prej një mëndjeje të hiqeshinë mbë-nj'-anë. I pari i tha, Bleva një arë, edhe kam nevojë të dal e t'e shoh; të lutem kij-më të-hequrë. ¹⁹ Edhe një tjetërë tha, Bleva pesë pëndë qe, edhe po vete t'i provonj; të lutem, kij-më të-hequrë. ²⁰ Edhe një tjetërë tha, Mora grua; edhe përاندaj nukë munt të vinj. ²¹ Edhe ay shërbëtori erdhi, edhe i dëfteu të zott këto. Atëhere i zot' i shtëpisë u zemërua, e i tha shërbëtorit të ti, Dil çpejt ndëpër rrugat e ndëpër udhët të qytetit, edhe bjerë këtu brënda të-vobeqt' e ulokët' e të-çalët e të-verbëritë. ²² Edhe shërbëtori tha, Zot, ubë sikundrë urdhërove, po edhe ka vënt. ²³ Edhe zotënia i tha shërbëtorit, Dil ndëpër udhët e ndëpër gjerdhet, edhe ngut të hynjënë, që të mbushetë shtëpia ime. ²⁴ Sepse po u them juve, se asnjë nga ata njerëzitë që qenë ftuarë nukë dotë ngjëronjë darkënë t'ime.

²⁵ Edhe shumë gjindje shkonin bashkë me atë; edhe **ay** ukthye e u tha atyre, ²⁶ Ndë arthtë ndonjë tek unë, edhe nukë mërzit t'an' e t'ëmën' e gruan' e djemt' e vëllezërit' e motëratë, po edhe jetën' e ti, nukë munt të jetë nxënësi im. ²⁷ Edhe ay që nukë mban mbë krahë kryqn' e ti, e s'vjen prapa meje nukë munt të jetë nxënësi im. ²⁸ Sepse cili prej jush do të ndërtonjë një pirk, edhe nukë rri më përpara të bënëjtë llogari sa ka për të prishurë, ndë ka ato **që duhenë** për të mbaruar' **atë**? ²⁹ Semos, si të hedhë themelinë, e të mos muntnjë t'e mbaronjë, gjith' ata që e shohënë zënë të qeshnjënë me atë, ³⁰ Dyke thënë, Se Ky njeri zuri të ndërtonjë, edhe nukë mundi të mbaronjë. ³¹ Apo cili mbret, dyke vaturë të luftonjë me tjetërë mbret, nukë rri më përpara edhe nukë mendonetë, ndë është i-fortë me dhjetë mijë t'i dalë përpara atij që vjen kundrë ti me një-zet mijë? ³² se ndë mos, tek është ay edhe po lark, dërgon lajmësi, e kërkon paqtim. ³³ Kështu pra gjithë-sicili prej jush që nukë mohan pasjen' e ti, nukë munt të jetë nxënësi im.

³⁴ Kripa është e-mirë; po ndë uprishtë kripa, me se dotë ndreqetë. ³⁵ Nuk' është më e-vejershme as për dhe as për plehë; **po** e hedhënë jashtë. Ay që ka veshë për të dëgjuarë letë dëgjonjë.

Krye 15

¹ Edhe gjithë kumerqarët' e fajtorëtë i u afëroneshinë, që t'e dëgjoninë. ² Edhe Farisenjt' e shkronjësitë murmurisninë, dyke thënë, Se ky pret fajtorë, edhe ha bashkë me ata. ³ Edhe ay u tha atyre këtë paravoli dyke thënë,

⁴ Cili njeri prej jush, ndë pastë një qint dhën, edhe të humpnjë një prej atyreve, nukë le të nëntë-dhjet' e nëntatë ndë shkretëtirët, edhe vete të kërkonjë atë që ka humburë, gjersa t'e gjenjë? ⁵ Edhe si t'e gjenjë, e merr mbi supat të ti dyke gëzuarë; ⁶ Edhe kur vjen ndë shtëpit, thërret miqt' edhe fqinjëtë, e u thot' atyre, Gëzohi bashkë me mua, se gjeta delenë t'ime që pati humburë. ⁷ Po u them juve, se kështu dotë jetë gëzim ndë qiellt për një fajtuar që pendonetë, se për nëntë-dhjet' e nëntë të-drejtë, të-cilëtë s'kanë nevojë për pendim.

⁸ A cila grua që ka dhjetë dhrahmi, ndë i humptë një dhrahmi, nukë ndes kandilenë, edhe fshin shtëpinë, edhe kërkon me kujdes, gjersa t'e gjenjë? ⁹ Edhe si t'ra gjenjë, thërret miqeshat' e fqinjatë, dyke thënë, gëzohi bashkë me mua, se gjeta dhrahminë që humba. ¹⁰ Kështu, po u them juve, bënëte gëzim përpara ëngjëjvet të Perëndisë për një fajtuar që pendonetë.

¹¹ Përsëri tha,

Një njeri kishte dy bij; ¹² edhe më i-vogëli nga ata i tha t'et, Atë, ep-më pjesën' e gjësë që më bje **për-të-marrë**. Edhe ay u'a ndau gjënë. ¹³ Edhe pas pak ditsh më i-vogëli mblodhi gjithë **ç'pat**, edhe iku ndë dhe të-huaj mbë një vënt të-largë; edhe atje çpërndau gjën' e ti dyke shkuarë jetë plankprishësi. ¹⁴ Edhe ay si prishi të-gjitha, ubë një zi e-madhe mb'atë vënt, edhe ay zuri të mos kishte më. ¹⁵ Atëhere vate e u ngjit pas një qytetari t'ati vëndi; edhe **ky** e dërgoj nd'arat të ti të kullotte derra. ¹⁶ Edhe dëshëronte të mbushte barkun' e ti me harupetë që haninë derratë; po as ndonjë nuk' i epte. ¹⁷ Edhe si erdhi ndë vetëhet të ti, tha, Sa punëtorëve të t'im et u tepëron bukë, e unë po humbas nga uria! ¹⁸ Dotë ngrihem e dotë vete tek im atë, edhe dot' i them, O Atë, fëjeva ndë qiellt edhe përpara teje; ¹⁹ Edhe nukë jam më i vëjyerë të quhem biri yt; bëjmë posi një nga punëtorët' e tu. ²⁰ Edhe ungrit e erdhi tek i ati. Edhe Ay tek po ishte edhe lark, i ati e pa edhe i erdhi keq, edhe usul e ra mbi qafët t'ati, edhe e puthi. ²¹ Edhe i biri i tha, O Atë, fëjeva ndë qiellt edhe përpara teje, edhe nukë jam më i-vëjyerë të quhem biri yt. ²² Po i ati u tha shërbëtorëve të ti, Nxirni jashtë stolin' e parë edhe vish-j'ani, edhe i viri unazë ndë dorët, edhe këpu-cë ndë këmbët; ²³ Edhe bini viçin' e-ushqyerë, edhe ther-e-ni, edhe letë ham' e të gëzonemi; ²⁴ Sepse ky biri im qe i-vdekurë, e ungjall përsëri; edhe qe i-humburë, e ungjënt. Edhe zunë të gëzonesthinë. ²⁵ Edhe m'i-madhi bir ishte nd'arët; edhe kur erdhi e u afërua ndë shtëpit, dëgjoj kënk' e valle. ²⁶ Edhe thirri një nga shërbëtorëtë edhe e pyeste, ç'janë këto. ²⁷ Edhe ay i tha, Se ka ardhur' yt vëlla; edhe yt atë theri viçin' e-ushqyerë, sepse e priti të-shëndoshë. ²⁸ Edhe **ay** uzëmërua, edhe nukë donte të hynte brënda. I ati pra dolli, e i lutej. ²⁹ Edhe ay upërgjeq e i tha t'et, Na tek po të shërbenj kaqë vjet, edhe kurrë nukë dolla nga urdhëri yt; edhe kurrë nukë më dhe një kec, që të gëzonem bashkë me miqt' e mi. ³⁰ Po kur erdhi ky yt bir që hëngri gjënë bashkë me kurvatë, i there viçin' e-ushqyerë. ³¹ Edhe ay i tha, O djalë, ti je përherë bashkë me mua, edhe gjithë të-miatë janë të-tuatë; ³² Edhe duhej të gëzonesthim' e të ngazëllonesthimë, sepse ky yt vëlla qe i-vdekurë, e ungjall përsëri; edhe qe i-humburë, e ungjënt.

Krye 16

¹ U thoshte edhe nxënësvet të ti,

Ishte një njeri i-pasurë që kishte një kujdestar; edhe i kallëzuanë keq për atë, se çpërndau gjën' e ati. ² Edhe **ay** e thirri e i tha, Ç'**është** këjo që dëgjonj për ty? ep

llogarin' e kujdesësë s'ate; sepse nukë mundetë më të jesh kujdestar. ³ Atëhere kujdestari tha me vetëhen' e ti, Ç'dotë bënj, që im zot po më heq nga kujdesa? të rëmonj nukë munt, të lypënj kam turp. ⁴ Ukujtuashë ç'**duhetë** të bënj, që të më presënë ndëpër shtëpirat të tyre, kur të nxirem nga kujdesa. ⁵ Edhe thirri përënë një nga detorët' e të zot, e i thoshte të-parit, Sa detyrë i ke t'im zott? Edhe ay i tha, Një qint bucela vaji, ⁶ edhe ay i tha, Merr të-shkruarënë t'ënde, edhe rri e shkruaj çpejt pesë-dhjetë. ⁷ Pastaj i tha një tjetëri, po ti sa detyrë i **ke**? Edhe ay i tha, Një qint matës gruri. I thot' edhe ati, Merr të-shkruarënë t'ënde, edhe shkruaj tetë-dhjetë. ⁸ Edhe i zoti e lëvdoj kujdestarin' e-paudhë, sepse punoj me mënt; sepse të bijt' e kësaj jete janë më të-mënçim ndë brest të tyre, se të bijt' e dritësë.

⁹ Edhe unë po u them juve, Bëni miq për vetëhenë t'uaj nga mamonaj i paudhërisë që t'u presënë juve ndë tendat të-përjetëshme, kur të ngrihi së-këtejmi.

¹⁰ Ay që është besëtar mbë të-pakënë, është besëtar edhe mbë të-shumënë.

¹¹ Ndë qoftë pra se s'ubëtë besëtarë mbë të-paudhinë mamona, kush dot'u besonetë juve të-vërtetënë gjë? ¹² Edhe ndë qoftë, se nukë ubëtë, besëtarë mbë **gjë**' e-huaj, kush dot'u apë juve t'uajnë? ¹³ Asndonj shërbëtuar nukë munt t'u shërbenjë dy zotërinjve; sepse a njërinë dot'e mërziinjë, edhe tjetrinë dot' e dojë; a pas njërit dotë ngjitetë, edhe tjetrinë dot' e hedhë tej. Nukë muntni t'i shërbeni Perëndisë edhe mamonaj.

¹⁴ Edhe Farisenjtë që ishinë dorë-shtrënguarë këto të-gjitha i dëgjoninë, edhe e përqeshninë.

¹⁵ Edhe **ay** u tha atyre, Ju jini ata që nxirni vetëhenë t'uaj të-drejtë përpara njerësvet; po Perëndia njej zëmëratë t'uaj; sepse ajo **gjë** që është e-lartë ndër njerëzit, ndyrësi është përpara Perëndisë. ¹⁶ Nomi edhe profitëritë **kanë qënë** gjer ndë **kohët** të Joanit; që atëhere epetë zër' i-mirë për mbretërin' e Perëndisë, edhe gjithë-sicili nxitonetë **të hynjë** ndë atë. ¹⁷ Edhe më kollaj është qielli edhe dheu të shkonjë, se të bjerë **poshtë** një pikë nga nomi. ¹⁸ Kushdo që lëshon gruan' e ti edhe martonetë me tjetërë, kurvëron; edhe kushdo që martonetë me grua të-lëshuarë prej burrit, kurvëron.

¹⁹ Edhe një njeri ishte i-pasurë, edhe vishej me porfirë e me stoli të-kuqe, dyke gëzuarë përdita ndriçim. ²⁰ Ishte edhe një i-vobek që e kish emërinë Llazar, i-cili dergjej përënë portës' s'ati plot me plagë, ²¹ Edhe dëshëronte të nginjej me thërrimetë që bininë nga truvez' e të-pasurit; po edhe qëntë vinin' e lëpininë plagët' e ati. ²² Edhe i-vobeku vdiq, edhe upru nga ëngjëjtë ndë gjit t'Avraamit. Vdiq edhe i-pasuri edhe ukall ndë varr. ²³ Edhe ndë hadht, tek ishte ndë mundime, ngriti syt' e ti, e sheh Avraaminë së-largu, edhe Llazarinë ndë gjit t'ati. ²⁴ Edhe ay thërriti e tha, O atë Avraam, përdëlle-më, edhe dërgo Llazarinë, që të ngjyenjë majën' e gishtit të ti ndë ujë, edhe të më ftohjë gjuhënë; sepse po mundonem ndë këtë flakë. ²⁵ Po Avraami i tha, O djalë, kujtohu, se ti more të-mirat' e tua ndë jetët t'ënde, edhe Llazari gjithashtu të-këqjatë; po tashi ky prëhetë, e ti mundone. ²⁶ Edhe mbi gjithë këto, ndër mest nesh e jush është ngulurë një pafundje e-madhe, që kështu ata që duanë të shkonjë së-këtejmi ndër ju, të mos muntjnë, as t'andejmitë të shkojnë ndër ne. ²⁷ Edhe **ay** tha, Të lutem pra, o atë, të dërgonjë atë ndë shtëpit të t'im et; ²⁸ Sepse kam pesë vëllezër; që të apë dëshmim ndër ata, që të mos vinjë edhe ata ndë këtë vënt të mundimit. ²⁹ Avraami i thotë, kanë Moisinë edhe profitëritë; letë ndigjonjën' ata. ³⁰ Edhe ay tha, Jo, o atë Avraam; po ndë vaftë ndonjë nga të-vdekuritë tek ata, dotë pendonënë. ³¹ Edhe **ay** i tha, Ndë qoftë se nukë ndigjonjën Moisinë edhe profitërit as ndë ungjalltë ndonjë nga të-vdekuritë, s'janë për të bindurë.

Krye 17

¹ Edhe u tha nxënësve, Eshtë **gjë** e-pamundurë të mos vinjënë skandalitë; po mjer' ay, me anë të të-cilit vinjënë. ² Më mirë është për atë t'i varetë një gur mulliri rreth qafës' s'ati, edhe të hidhetë ndë dett, se të skandalisnjë një nga këta të-vegjëlitë. ³ Vini re vetëhenë t'uaj. Edhe ndë të bëftë faj yt vëlla, qërto-e; edhe ndë upendoftë, fal-j'a. ⁴ Edhe ndë bëftë faj shtatë herë ndë ditët, edhe të kthenetë shtatë herë ndë ditët tek ti, e të thotë, Pendonem, t'j'a falç.

⁵ Edhe apsotojt' i thanë Zotit, Shto-na besënë. ⁶ Edhe Zoti tha, Po të kishitë besë sa një koqe sinapi, dot'i thoshitë këti druri të manit, Shkulu **së-këtejmi**, edhe mbillu ndë dett, edhe dot'u ndigjonte juve. ⁷ Edhe cili prej jush, që ka një shërbëtuar që lëron, a ruan dhëntë, dot'i thotë këti për-një-herë, posa të kthenetë nga ara, Shko e rri të hash? ⁸ Apo nukë dot'i thotë, Bëj gati ç'të ha për darkë, edhe përvishu e shërbemë, gjersa të ha e të pi, edhe pastaj dotë hash e dotë pish ti? ⁹ Mos j'a njuh për hir ati shërbëtori, sepse bëri ato që e urdhëroj? Nukë më duketë. ¹⁰ Kështu edhe ju, kur të bëni gjithë sa u janë urdhëruarë, thoni, Se jemi shërbëtorë të-pavëjyerë, sepse bëm' atë që kishimë detyrë të bënimë.

¹¹ Edhe ay kur po vinte për ndë Jerusalem, shkonte përmes Samarisë e Galileës. ¹² Edhe kur po hynte ndë një fshat, përpoqnë me atë dhjetë burra të-kromosurë, të-cilëtë qëndruanë prej së-largu; ¹³ Edhe ata ngritnë zënë, dyke thënë, Jisu, mjeshtrë, përdëlle-na. ¹⁴ Edhe **ay** kur i pa, u tha atyre, Shkoni e dëfteni vetëhenë t'uaj te priftëritë. Edhe ata dyke vaturë uqëruanë. ¹⁵ Edhe një nga ata, kur pa se ushërua, ukthye dyke lavdurua-rë Perëndinë me zë të-math; ¹⁶ Edhe ra përmbyndër këmbët t'ati, e i uval ndersë; edhe ay ishte Samarit. ¹⁷ Edhe Jisuj u përgjeq e tha, A nuk' uqëruanë të dhjetëtë? po të nëntëtë ku janë? ¹⁸ Nuk' ugjëntnë të-tjerë të kthenenë që t'i apënë lavdi Perëndisë, veç ky tjetërë-kombës? ¹⁹ Edhe i tha, Ngreu, e shko; besa jote të shpëtoj.

²⁰ Edhe kur upyet nga Fariensjtë, kur vjen mbretëri' e Perëndisë, upërgjeq atyre e tha, Mbretëri' e Perëndisë nukë vjen me të-dukurë; ²¹ As s'kanë për të thënë, Na këtu **është**, a, Na atje; sepse na mbretëri' e Perëndisë tek është ndë mes t'uaj.

²² Edhe **ay** u tha nxënësve, Dotë vinjënë dit, kur dotë dëshëroni të shihni një nga ditt' e të Birit të njeriut; edhe nukë dotë muntni. ²³ Edhe dot' u thonë juve, Na këtu **është**, a, Na atje; mos ecëni, as mos vini pas. ²⁴ Sepse sikundrë vetëtima që vetëtini prej njërësë anë ndënë qiellit ndrit gjer mbë tjetrënë anë ndënë qiellit, kështu dotë jetë edhe i Bir' i njeriut ndë ditët të ti. ²⁵ Po më përpara ay duhetë të pësonjë shumë, edhe të mos pëlqenetë prej këti brezi. ²⁶ Edhe sikundrë ubë ndë ditt të Noesë, kështu dotë jetë ndë ditt të Birit të njeriut; ²⁷ hanin' e pinin' e martonin' e martoneshinë, gjer mb'atë ditë që hyri Noeja nd'arkët; edhe erdhi përmytja, edhe prishi të-gjithë. ²⁸ Kështu sikundrë ubë edhe ndë ditt të Llotit; hanin' e pinin' e blinin' e shisnin' e mbillinin' e ndërtoninë shtëpi; ²⁹ Edhe që mb'atë ditë që doli Lloti nga Sodhoma, ra shi zjarri e shqufuri nga qielli, edhe prishi të-gjithë; ³⁰ Posi këto dotë jetë nd'atë ditë që dotë çfaqet' i Bir' i njeriut. ³¹ Nd'atë ditë kush të gjendetë mbë dhomët, edhe enët' e ati brënda ndë shtëpit, letë mos sbresë t'i ngrerë; edhe ay që të gjendetë nd' arët, gjithashtu letë mos kthenetë prapa. ³² Bini ndër mëntt gruan e Llotit. ³³ Ay që dotë kërkonjë të shpëtonjë jetën' e ti, dot' e humpnjë; edhe ay që t'e humpnjë; dot'e ruanjë. ³⁴ Po u them juve, Nd'atë natë dotë jenë dy **veta** mbë një shtrat; njëri dotë merretë, e tjetëri dotë lihetë. ³⁵ Dy **gra** dotë jenë dyke bluarë bashkë; njëra dotë merretë, e tjetëra dotë lihetë. ³⁶ Dy veta dotë jenë nd'arët; njëri dotë merretë, e tjetëri dotë lihetë.

³⁷ Edhe **ata** upërgjeqnë e i thonë, ku o Zot? Edhe ay u tha atyre, Ku **është** trupi, atje dotë mblihdhenë shqiponjatë.

Krye 18

¹ U thoshte atyre edhe një paravoli, që **t'u tregonte**, se duhetë të falenë gjithënjë, edhe të mos lodhenë, ² Dyke thënë,

Ndë një qytet ishte një gjykatës, i-cili s'kishte frikë nga Perëndia, edhe s'kishte turp nga njeri. ³ Ishte edhe një e-ve nd'atë qytet; edhe vinte tek ay, dyke thënë, Ep-më të-drejtënë prej kundrëgjyqësit t'im. ⁴ Edhe ay gjer mbë një kohë nukë donte; po pastaj tha me vetëhe, Ndonëse s'kam frikë nga Perëndia; edhe s'kam turp nga njeri, ⁵ Pak-së-paku, sepse këjo e-ve më bënetë barrë, let'ja ap të-drejtënë, që të mos vinjë gjithënjë e të më çajë kryetë.

⁶ Edhe Zoti tha, Dëgjoni ç'thotë gjykatësi i-paudhë. ⁷ Po Perëndia a nukë dot'u apë të-drejtënë të-sgjedhurvet të ti që thërresënë tek ay dit' e natë, kur edhe zëmërenë e ka të-gjerë për ata? ⁸ Po u them juve, se dot'u'a apë atyre të-drejtënë për-së-çpejti. Po kur të vinj' i Bir' i njeriut, vallë a dot' e gjenjë besënë mbi dhët?

⁹ Edhe cave nga ata që besoneshinë mbë vetëhen' e tyre, se janë të-drejtë, edhe nuk' i zininë për gjë të-tjerëtë, u tha këtë paravoli.

¹⁰ Dy njerës hipnë ndë hieroret, që të faleshinë; njeri ishte Farise edhe tjtëri kumerqar. ¹¹ Fariseu ndënji e falej me vetëhen' e ti, dyke thënë, O Perëndi, të falem ndersë, se nukë jam posi njerëzit' e-tjerë, rrëmbenjës, të-paudhë, kurvarë, a edhe posi ky kumerqar. ¹² Agjëronj dy herë ndë javët, ap të-dhjetënë nga gjithë ç'kam. ¹³ Edhe kumerqari kishte ndënjurë së-largu e nukë donte as sytë të-ngrij përjetë ndë qiellt, po rrihte krahërorin' e ti dyke thënë, O Perëndi, përdëlle-më mua fajtorinë. ¹⁴ Po u them juve, **se** ky sbriti ndë shtëpit të ti **m'i** drejtëuarë se ay, sepse kushdo që ngre lart vetëhen' e ti, dotë përunjëtë: edhe ay që përunj vetëhen' e ti, dotë ngrihetë lart.

¹⁵ Edhe i prunë ati edhe foshnjatë që t'i zinte me dorë; edhe nxënësitë kur panë, i qërtuanë. ¹⁶ Po Jisuj si i thërriti përanë, tha, Liri çunat' e-vegjëlë të vijnë tek unë edhe mos i ndalni; sepse e të-këtillevët është mbretëri' e Perëndisë. ¹⁷ Me të-vërtetë po u them juve, **se** Ay që të mos presë mbretërin' e Perëndisë posi një çun i-vogëlë, nukë dotë hynjë nd'atë.

¹⁸ Edhe një i-parë e pyeti, dyke thënë, Mësonjës i-mirë, ç'të bënj që të trashëgonj jetë të-përjetëshme? ¹⁹ Edhe Jisuj i tha, Ç'më thua i-mirë? asnjë nuk' është i-mirë, përveç një, Perëndia, ²⁰ **Ti** i di porositë, "Mos kurvëronjç; Mos vraç; Mos vjethç; Mos apç dëshmim të-rrem; Ndero të t'at' e t'ët ëmë." ²¹ Edhe ay tha, Të-gjitha këto i kam ruajturë që mbë të-rit t'im. ²² Edhe Jisuj, kur dëgjoj këto, i tha. Edhe një punë të mungon; shit gjithë ç'ke, edhe i ndaj ndëpër të-vobeq, edhe dotë kesh thesar ndë qiell; edhe eja, e ngjit-m'u pas. ²³ Po ay kur dëgjoj këto, uhidhërua; sepse ishte fort i-pasurë.

²⁴ Edhe Jisuj kur pa, se uhidhërua, tha, Sa me të-vështirë dotë hynjënë ndë mbretërit të Perëndisë ata që kanë gjë! ²⁵ Sepse më kollaj është të hynjë kamilla ndëpër vrimët të gjëlpërësë, se **një** i-pasurë të hynjë ndë mbretërit të Perëndisë.

²⁶ Edhe ata që dëgjuanë thanë, E kush munt të shpëtonjë? ²⁷ Edhe ay tha, Të-pamunduratë te njerëzitë janë të-mundura te Perëndia.

²⁸ Edhe Pjetri tha, Ja neve tek lamë të-gjitha, edhe të erthmë pas. ²⁹ Edhe ay u tha atyre, Me të-vërtetë po u them juve, se nuk' është asnjë që la shtëpi, a prindër, a vëllezër, a grua, a djem, për punë të mbretërisë së Perëndisë, ³⁰ I-cili të mos trashëgonjë për një shumë ndë këtë kohë, edhe ndë jetët që vjen jetë të-përjetëshme.

³¹ Pastaj mori mbë nj'anë të dy-mbë-dhjetëtë, e u tha atyre. Na tek po hipëjmë ndë Jerusolim, edhe dotë mbushenë gjithë sa janë shkruarë me anë të profitërvet për të Birin' e njeriut; ³² Sepse dotë epetë ndër duart të kombevet, e dotë pshtyhetë;

³³ Edhe si t'a frushkullonjënë dot' e vrasënë; edhe të-tretënë ditë dotë ngjalletë.

³⁴ Po ata nukë muarnë vesh asnjë nga këto **fjalë**; edhe këjo fjalë ishte e-fshehurë nga ata, edhe nukë merrninë vesh ato që u thuheshin' atyre.

³⁵ Edhe ay kur uafërua ndë Jeriho, një i-verbërë po rrinte për'an' udhësë dyke lypurë; ³⁶ Edhe kur dëgjoj gjindjenë dyke shkuarë, pyeste, Ç'është këjo? ³⁷ Edhe i dëftyenë, se po shkon Jisu Nazoreasi. ³⁸ Edhe **ay** thirri dyke thënë, Jisu, bir' i Dhavidhit, Përdëlle-më. ³⁹ Edhe ata që shkoninë përpara e qërtoninë që të pushonjë; po ay shumë më tepërë thërriste, Bir' i Dhavidhit, përdëlle-më.

⁴⁰ Edhe Jisuj qëndroj, edhe urdhëroj t'e bjenë tek ay; edhe ay si uafërua, e pyeti, ⁴¹ Dyke thënë, Ç'do të të bënj? Edhe ay tha, Zot, të hap sytë e të shoh. ⁴² Edhe Jisuj i tha, Hap sytë e shih; besa jote të shpëtoj. ⁴³ Edhe sa-kaqë-herash hapi sytë e pa, edhe i vinte pas dyke lavdruarë Perëndinë; edhe gjithë llauzi kur pa, i dha lavdi Perëndisë.

Krye 19

¹ Edhe Jisuj hyri e shkonte ndëpër Jeriho.

² Edhe na një njeri që quhet Zakhe, i-cili ishte i-par' i kumerqarëvet, edhe ky ishte i-pasurë; ³ Edhe kërkonte të shihte Jisunë cili është; po nukë munte nga gjindja, sepse ishte i-vogëlë ndë shtat. ⁴ Edhe u sul përpara, e hipi mbë një dru mani, që t'e shihte, sepse nga ajo **udhë** dotë shkonte. ⁵ Edhe Jisuj si erdhi nd' **atë** vënt, ngriti sytë edh' e pa atë, edhe i tha, Zakhe, sbrit çpejt; sepse sot duhetë unë të mbetem ndë shtëpit t'ëndë. ⁶ Edhe **ay** sbriti çpejt, edhe e priti dyke gëzuarë.

⁷ Edhe të-gjithë kur panë murmurisninë, dyke thënë, Se hyri të rrijë te një fajtuar njeri.

⁸ Edhe Zakheu qëndroj e i tha Zotit, na, o Zot, gjysmën' e gjësë s'ime tek po u'a ap të-vobeqvet, edhe ndë i kam marrë gjë njeriu me përdhunë, j'a kthenj për një katrë. ⁹ Edhe Jisuj i tha, Se sot ubë shpëtim ndë këtë shtëpi, sepse edhe ky është i bir' i Avraamit. ¹⁰ Sepse i Bir' i njeriut erdhi të kërkonj' e të-shpëtonjë të-humburënë.

¹¹ Edhe ata kur dëgjoninë këto, Jisuj shtoj e tha një paravoli, sepse ishte afërë Jerusallimit, edhe ata pandehninë, se sa-kaqë-herash dotë dukej mbretëri' e Perëndisë. ¹² Tha pra.

Një njeri i-fisçim vate mbë një vënt të-largë, për të marë një mbretëri për vetëhen' e ti, e pastaj të kthenetë. ¹³ Edhe thirri dhjetë shërbëtorë të ti, e u dha dhjetë mna, edhe u tha, Punoni këto gjer sa të vinj. ¹⁴ Po qytetarët' e ati e kishinë çmir edhe dërguanë lajmësi pas ati, dyke thënë, Nukë duamë këtë të mbretëronjë mbi ne. ¹⁵ Edhe si mori mbretërinë ukthye prapë, edhe tha të thëritenë tek ay ata shërbëtorëtë të-cilëvet u pat dhënë ergjendinë, për të marrë vesh ç'kishte fituarë gjithë-sicili. ¹⁶ Edhe erdhi i-pari, dyke thënë, Zot, mnaja jote fitoj dhjetë mna. ¹⁷ Edhe ay i tha, Të lumtë, shërbëtor i-mirë; me-qënë-që ubërë besëtar ndë të-pakënë, ki pushtet përmbi dhjetë qytete. ¹⁸ Erdhi edhe i-dyti, dyke thënë, Zot, mnaja jote bëri pesë mna. ¹⁹ I tha edhe këti, edhe ti bëhu **zot** përmbi pesë qytete. ²⁰ Erdhi edhe tjetëri, dyke thënë, Zot, na mnaja jote të-cilën' e pata ruajturë ndë një rizë; ²¹ Sepse të pata frikë, se je njeri i ashpërë; merr atë që s'ke vënë, edhe korr atë që s'ke mbjellë. ²² Edhe **ay** i thotë, Prej gojësë s'ate të kam për të gjykuarë, shërbëtor i-keq; ti e dinje, se unë jam njeri i-ashpërë, edhe marr atë që s'kam vënë, edhe korr atë që s'kam mbjellë; ²³ Përse pra nukë dhe ergjendinë t'im ndë truvezët, që, korr të vinjam unë, t'a merrjam bashkë me kamatënë? ²⁴ Atëherë u tha atyre që rrininë përpara, Merrni mnanë prej ati, edhe ep-j'a-ni ati që ka të dhjetë mnatë. ²⁵ (Edhe ata i thanë, Zot, **ay** ka dhjetë mna.) ²⁶ Sepse po u them juve, se kujdo që ka dot'i epetë; edhe prej ati që s'ka, edhe ajo që ka dotë merretë prej ati.

²⁷ Po ata armiqt' e mi që s'më deshnë të mbretëronj mbi ata, birni këtu, edhe therni ata përpara meje.

²⁸ Edhe si tha këto, shkante përpara, dyke hipurë ndë Jerusolim.

²⁹ Edhe si uafërua ndë Vithfagji edhe ndë Vithani, ndë malit që quhetë i Ullinjet, dërgoj dy **vet**a nga nxënësit' e ti, ³⁰ Dyke thënë **atyre**, Shkoni ndë fshat të-përtej; ndë të-cilët kur të hyni, dotë gjeni një pulisht lidhurë; përmbi të cilinë asnjeri kurrë s'ka hipurë; sgidh-e-ni edhe sill-e-ni. ³¹ Edhe ndë u pyetë juve ndonjë, Përse e sgithni? kështu t'i thoni, Se Zoti ka nevojë prej ati.

³² Edhe si vanë ata që udërguanë, gjetnë sikundrë u tha atyre. ³³ Edhe ata kur po sgithninë pulishtinë, të zotërit' e ati u than' atyre. Përse sgithni pulishtinë? ³⁴ Edhe ata u thanë, Zoti ka nevojë prej ati. ³⁵ Edhe e prunë te Jisuj. Edhe si hodhë rrobat' e tyre mbi pulishtinë, hipnë Jisunë mbi atë. ³⁶ Edhe tek po shkante, **gjindja** shtroninë rrobat' e tyre udhësë.

³⁷ Edhe ay kur uafërua ndashti mbë të-sbriturit të malit t'Ullinjet, gjithë shumica e nxënësët zunë të gëzoshin' e të lavduroninë Perëndinë me zë të math për gjithë çuditë që panë, ³⁸ Dyke thënë, I-bekuarë **qoftë** mbreti që vjen mb'emërit të Zotit; paqtim ndë qiell, edhe lavdi mbë të lartat.

³⁹ Edhe ca Farisenj prej gjindjesë i thanë, Mësonjës, qërto nxënësit' e tu. ⁴⁰ Edhe ay upërgjeq e u tha atyre, Po u them juve, se ndë pushofshinë këta, gurëtë dotë thërresënë.

⁴¹ Edhe kur uafërua, e pa qytetnë, qau për atë, ⁴² Dyke thënë, Se sikur të dinje edhe ti, pak së-paku **sot** ndë këtë ditët t'ënde, ato që **janë** për paqtimnë t'ënt, **sa mirë do ishte**? Po tashi ufshehnë prej syve të tu, ⁴³ Sepse kanë për të ardhurë dit mbi ty, edhe armiqt' e tu kanë për të bërë hendek rreth teje, edhe të kanë për të rrethuarë, edhe të kanë për të shtrënguarë nga të gjith' anëtë; ⁴⁴ Edhe kanë për të rrëzuarë poshtë ty edhe djemt' e tu **që gjendenë brënda** tek ti, edhe nukë kanë për të lënë tek ti gur mbi gur; sepse nukë njohe kohënë që **erdhë** për të parë ty.

⁴⁵ Edhe si hyri ndë hieroret, zuri t'i nxirte jasht' ata që shitnin' e blininë nd'atë,

⁴⁶ Dyke thën' atyre, Eshhtë shkruarë, "Shtëpia ime është shtëpi lutje;" po ju e bëtë "shpellë kursarësh."

⁴⁷ Edhe ishte dyke mësuarë përdita ndë hieroret; edhe kryepriiftërit' e shkronjësitë edhe të-parëtë e llauzit kërkoninë t'e prishninë; ⁴⁸ po nukë gjeninë se ç't'i bëninë; sepse gjithë llauzi ishte varurë pas ati për të dëgjuar' atë.

Krye 20

¹ Edhe ndë një nga ato dit, tek mësonte ay llauzinë ndë hieroret, edhe epte zën' e-mirë, kryepriiftërit' edhe shkronjësitë bashkë me pleqtë erdhë për'an' **ati**, ² E i folnë, dyke thënë, Thuajna, me ç'pushtet bën këto? a cili është' ay që të ka dhënë këtë pushtet? ³ Edhe **ay** upërgjeq e u tha atyre, Edhe unë dot' u pyes juve një fjalë, edhe thoj-më-ni, ⁴ Pagëzimi i Joanit prej qielli ishte a prej njerëzish? ⁵ Edhe ata mendonëshinë me vetëhen' e tyre, dyke thënë, Se ndë thënçimë, Prej qielli, dotë thotë, Përse s'i besuatë pra? ⁶ Po ndë thënçimë, Prej njerëzish, gjithë llauzi dotë na rrahë me gurë, sepse i është mbushurë mëndja, se Joani është profit. ⁷ Edhe upërgjeqnë, se nukë dinë nga **ishte**. ⁸ Edhe Jisuj u tha atyre, As unë nuk' u them me ç'farë pushteti bën këto.

⁹ Pastaj zuri t'i thoshte llauzit këtë paravoli: Një njeri beltoj një veshtë, edhe e dha ndër bujqër, edhe vate ndë dhe të-huaj për shumë kohë. ¹⁰ Edhe ndë kohët **të pemëvet** dërgoj një shërbëtuar te bujqëritë, që t'i epninë prej pemës' së veshtit; po bujqërit' e rrahnë, edhe e dërguanë sbrazëtë. ¹¹ Edhe përsëri dërgoj një tjetërë shërbëtuar; po ata edhe atë e rahnë, edhe e turpëruanë, edhe e dërguanë zbrazëtë. ¹² Edhe përsëri dërgoj një të-tretë; po ata edhe këtë e bënë me plagë

edhe e dëbuanë. ¹³ Edhe i zot' i veshitit tha, Ç'të bënj? letë dërgonj birinë t'im të-dashurinë; mbase kur të shohënë këtë, dotë kenë turp. ¹⁴ Po bujqëritë kur e panë, mendoneshinë me vetëhe, dyke thënë, Ky është trashëgimtari; ejani, le t'a vrasmë, që të na mbetetë trashëgimi. ¹⁵ Edhe e nxuarë jashtë veshitit, edhe e vranë. Ç'dot'u bënjë pra atyre i zot' i veshitit? ¹⁶ Dotë vinjë e dot'i prishnjë këta bujqër, edhe veshitinë dot'u a apë të-tjerëve.

¹⁷ Po **ata** kur dëgjuanë, thanë, Qoftë lark! Edhe ay shtyri sytë mb'ata e tha, Ç'është pra këjo që është shkruarë, "Gurinë që nuk' e pëlqye-në ata që ndërtonjënë, ky ubë për krye çipi?" ¹⁸ Kushdo që të bjerë mbi atë gur dotë copëto-netë; edhe mb'atë që të bjerë, dot'e dërmonjë.

¹⁹ Edhe kryepriiftërit' e shkronjësitë kërkuanë të vënë duartë mbi atë nd'atë orë; po patnë frikë nga llauzi; sepse e muarnë vesh, se për ata e tha këtë paravoli.

²⁰ Edhe dyke ruajturë atë për së-afërmi, dërguanë përgjonjës, të-cilëtë shtiheshinë se janë të-drejtë, me qëllim që ta zininë prej fjale, që t'a epninë ndë dorët të urdhërit edhe ndë pushtet të qivernitarit.

²¹ Edhe e pyetnë, dyke thënë, Mësonjës, e dimë se flet e mëson drejtë, edhe nuk' i mban anë njeriu, po mëson udhën' e Perëndisë me të-vërtetë, ²² A është e udhësë t'i apëmë neve Qesarit pagë, a po jo? ²³ Edhe **ay** si mori vesh dinakërin' e atyre, u tha atyre, përse më ngitni? ²⁴ Dëfte-më-ni një dinar. Të kujt e ka fytyrë e përmbishkronjë? Edhe ata upërgjeqnë e thanë, Të Qesarit. ²⁵ Edhe ay u tha atyre, Ep-ni pra Qesarit ato që janë të Qesarit, edhe Perëndisë ato **që janë** të Perëndisë. ²⁶ Edhe nukë muntnë t'e zininë prej fjale përpara llauzit; edhe uçuditnë për të-përgjegjurit' e ati, edhe s'bënë zë.

²⁷ Uafëruan' edhe disa veta prej Saduqenjet, të-cilëtë mohonjënë, se ka të-ngjallurë, edhe e pyetnë, ²⁸ Dyke thënë, Moisiu na ka shkruarë, Ndë i vdektë ndonjëj vëllaj që ka grua, edhe ky të vdesë pa lënë fëmijë, i vëllaj i ati të marrë gruanë, edhe të ngjallnjë farë për të vëllan' e ti. ²⁹ Ishin pra shtatë vëllezër; edhe i-pari mori grua, edhe vdiq pa **lënë** fëmijë. ³⁰ Edhe i-dyti mori gruanë; edhe ky vdiq pa **lënë** fëmijë. ³¹ Edhe i-treti e mori atë; gjithashtu edhe të shtatëtë; edhe nukë lanë fëmijë, edhe vdiqnë, ³² Edhe më pas nga të-gjithë vdiq edhe gruaja. ³³ Ndë të-ngjallurit pra, e kujt nga ata dotë jetë grua? sepse edhe të shtatë e patnë atë grua. ³⁴ Po Jisuj upërgjeq e u tha atyre, Të-bij' e kësaj jete martonjën' e mar-tonenë; ³⁵ Po ata që ubënë të-zotër të fitonjën' atë jetë edhe të-ngjalluritë prej së-vdekurish as martonjën' as martonenë; ³⁶ Sepse as të vdesënë nukë muntnjënë më; sepse janë si-një-një me ëngjëjtë; edhe janë bij të Perëndisë, kur janë bij të të-ngjallurit. ³⁷ Edhe se ngjallenë të-vdekuritë, edhe Moisiu e dëfteu ndë ferrët, kur thotë, Zotinë Perëndin' e Avraamit edhe Perëndin' e Isaakut edhe Perëndin' e Jakovit. ³⁸ Edhe Perëndia nuk' është **Perëndi** të-vdekurish, po të-gjallësh; sepse të-gjithë rronjënë mb'atë. ³⁹ Edhe disa nga shkronjësit' upërgjeqnë, e thanë, ⁴⁰ Mësonjës, mirë the. Edhe nukë kuxoninë më t'a pyetninë për asgjë.

⁴¹ Edhe ay u tha atyre, Qysh thonë, se Krishti është bir' i Dhavidhit? ⁴² Edhe Dhavidhi vetë thotë ndë vivit të Psallmevet, "I tha Zoti Zotit t'im, rri mbë të-djathtët t'im, ⁴³ gjersa të vë armiqt' e tu ndënëkëmbje të këmbëvet të tua." ⁴⁴ Dhavidhi pra e quan atë Zot, e qysh është i bir' i atit? ⁴⁵ Edhe tek po dëgjonte gjithë llauzi, u tha nxënëset të ti, ⁴⁶ Ruhi nga shkronjësitë që duanë të ecënjënë të-stolisurë, edhe duanë të-përsëndoshura ndëpër tregjet, edhe fronet' e-parë ndëpër sinagogjit, edhe vëndet' e-parë ndëpër darkat; ⁴⁷ Të-cilëtë hanë shtëpit' e të-vavet, dyke shtyrë shkak se falenë shumë. Këta dotë marrënë më tepërë mundim.

Krye 21

¹ Edhe shtyri syt' e pa të-pasuritë që hithninë dhuratat' e tyre ndë thesart. ² Pa edhe një grua të-ve e të-vobektë dyke hedhurë atje dy të-imëta; ³ Edhe tha, Me të-vërtetë po u them juve, se këjo grua e-ve edhe e-vobektë hodhi më shumë se të-gjithë; ⁴ Sepse gjithë këta prej tepëricës' së tyre hothnë ndë dhuratat të Perëndisë, po kjo prej skamjes' së saj hodhi gjithë gjën' e saj që pat.

⁵ Edhe disa tek po flisninë për hierorenë, se është e-stolisurë me gurë të-bukur' e me dhurata, tha, ⁶ Këto që vini re, dotë vinjënë dit, ndë të-cilat nukë dotë mbetetë gur mbi gur, që të mos rrëzonetë.

⁷ Edhe e pyetnë, dyke thënë, Mësonjës, kur pra dotë bënenë këto? edhe ç'shënjë **dotë jetë**, kur dotë bënenë këto?

⁸ Edhe ay tha, Shikoni të mos gënjehi; sepse shumë veta dotë vinjënë mb'emërit t'im, dyke thënë, Se unë jam; edhe se Koha uafërua. Mos shkoni pra prapa atyreve. ⁹ Edhe kur të dëgjoni luftëra e trazyra, mos ufrikësoni; sepse këto duhetë të bënenë më përpara; po nuk' **është** për-një-herë fundi.

¹⁰ Atëhere u thoshte atyre, Dotë ngrihetë komp kundrë kombi, edhe mbretëri kundrë mbretërie; ¹¹ Edhe dotë bënenë tërmete të-mëdhenj vënde mbë vënde, edhe zira e murtaja, edhe dotë jenë gjërra të-frikçime e shënja të mëdha prej qiellit.

¹² Po para gjithë këtyreve dotë vënë duart' e tyre mbi ju, edhe dot'u ndjekënë, e dot'u apënë ndër duar ndëpër sinagogji e ndëpër burgje, dyke prurë juve përpara mbretërve për punë t'emërit t'im. ¹³ Edhe **Këjo** dot'u jetë juve për dëshmim.

¹⁴ Viri pra ndë zëmërat t'uaj **këtë**, të mos mendo-hi më përpara me çfjalë të përgjigji; ¹⁵ Sepse unë dot'u ap juve gojë e urtësi, ndë të-cilët nukë dotë muntnjënë të flasënë kundrë, as të rrinë kundrë gjithë kundrështarëtë t'uaj. ¹⁶ Edhe dotë epeni ndë dorë edhe prej prindërsh e prej vëllezërish e prej njerëzish t'uaj e prej miqsh; edhe dotë vrasënë **disa** prej jush; ¹⁷ Edhe të-gjithë dot'u kenë çmir juve për emërinë t'im; ¹⁸ Po **asnjë** qime prej krejt t'uaj s'është për të humburë. ¹⁹ Me durimnë t'uaj dotë fitoni shpirtetë t'uaj.

²⁰ Edhe kur të shihni Jerusolimënë të-rrethuarë prej ushtërive, atëhere di-e-ni, se uafërua të-shkretuarët' e asaj. ²¹ Atëhere ata **që të jenë** ndë Judhe, letë ikëjnë ndëpër malet; edhe ata **që të jenë** brënda nd'atë, letë dalënë jashtë, edhe ata që të jenë në fshatërat, letë mos hynjënë brënda nd'atë. ²² Sepse dit çpagimi jan' ato, që të mbushenë gjith'ato që janë shkruarë. ²³ Edhe mjer' ato gra që janë me barrë e që kanë foshnjë mbë gji nd'ato dit sepse dotë jetë shtrëngim i-math mbi dhet, edhe zëmërim mbë këtë llaus. ²⁴ Edhe dotë bjenë me gojë thike, edhe dotë skllavosenë ndëpër gjithë kombet; edhe Jerusalisa dotë shkeletë prej kombesh, gjersa të mbushenë kohërat' e kombevet.

²⁵ Edhe dotë jenë shënja ndë djellët e ndë hënët e ndë yjt; edhe mbi dhet shtrëngim kombesh që nukë dinë **ç'dotë bënenë**; edhe dotë buçinjë deti edhe valëtë; ²⁶ Njerëzet dot' u dalë shpirti nga frika e nga të-priturit' e të-këqiavet që po vinjënë mbi botët; sepse fuqit' e qiellit dotë tundenë. ²⁷ Edhe atëhere dotë shohënë të Birin' e njeriut dyke ardhurë ndë re me fuqi e me lavdi të-madhe. ²⁸ Edhe kur të zënë këto të bënenë, shikoni lart edhe ngrini krerëtë t'uaj; sepse po afëronetë çpërbli miuj.

²⁹ Edhe u tha atyre një paravoli. Shihni drurin' e fikut edhe gjithë drurëtë; ³⁰ tashti kur të çelenë, dyke parë prej vetiu mermi vesh, se tashti vera është afërë.

³¹ Kështu edhe ju, kur të shihni këto se bënenë, t'a dini, se mbretëri e Perëndisë është afërë. ³² Me të-vërtetë po u them juve, se ky bres nukë dotë shkonjë, gjersa të bënenë të-gjitha **këto**. ³³ Qielli edhe dheu dotë shkonjënë, po fjalët' e mia nukë dotë shkonjënë.

³⁴ Edhe vini re vetëhenë t'ua, se mos u rëndonenë zëmëratë prej të-dejturit e prej të-pirit e prej kujdesevet të jetësë, e vinjë përmbi ju papandehuraj ajo ditë;

³⁵ Sepse posi lak dotë vinjë përmbi gjith'ata që rrinë mbi faqet të gjithë dheut.

³⁶ Rrini sgjuarë pra dyke luturë mbë çdo kohë, që të bëneni të-zotër të shpëtoni nga gjithë këto që janë për të bërë, edhe të rrini përpara të Birit të njeriut.

³⁷ Edhe ditënë mësonite ndë hieroret, po natënë dilte jashtë, e e shkonte natënë ndë malt që quhetë i Ullinjet. ³⁸ Edhe gjithë llauzi vinte që me natë tek ay ndë hieroret për të dëgjuar' atë.

Krye 22

¹ Edhe po afëronej e-kremtja e të-pabrumjever, që quhetë Pashkë. ² Edhe kryepfritërit e shkronjësitë kërkoninë se qysh t'a vrisninë; sepse kishinë frikë prej llauzit.

³ Edhe Satanaj hyri te Judha që quhej Iskariot, i-cili ishte nga numëri i të dy-mbë-dhjetët; ⁴ Edhe vate e foli me kryepfritërit' e me të-parët' e ushtëtarëvet, se qysh t'u'a apë ndër duar. ⁵ Edhe ata ugëzuanë, edhe bënë fjalë t'i apënë ergjënt.

⁶ Edhe **ay** uzotua edhe kërkonte kohë të-pëlqyerë që t'u'a iptë ndër duar pa bërë trazyrë.

⁷ Edhe erdhi dit' e të-pabrumjever, ndë të cilët duhej të therej kurban' i pashkësë.

⁸ Edhe **Jisuj** dërgoj Pjetrin' edhe Joaninë, dyke thënë, Ecëni edhe na bëni gati pashkënë, që të hamë. ⁹ Edhe ata i thanë, ku do të bëjmë gati? ¹⁰ Edhe ay u tha atyre, kur të hyni ju ndë qytet, na tek dot'u pjekë juve një njeri dyke mbajturë një shtëmbë uji; hiqni pas ati ndë shtëpit, ku të hynjë; ¹¹ edhe dot'i thoni të Zotit të shtëpisë, Mësonjësi të thotë ty, ku është vëndi, ku dotë ha pashkënë bashkë me nxënësit' e mi. ¹² Edhe ay dot' u dëftenjë juve një dhomë të-madhe të shtruarë; atje bëni gati. ¹³ Edhe ata si vanë, gjet-në sikundrë u tha atyre; edhe bënë gati pashkënë.

¹⁴ Edhe kur erdhi ora ndënji ndë mësallët, edhe të dy-mbë-dhjetët' apostoj bashkë me atë. ¹⁵ Edhe u tha atyre, Me dëshërim dëshirova të ha këtë pashkë me ju, para se të pësonj; ¹⁶ Sepse po u them juve, se s'kam për të ngrënë më prej asaj, gjersa të mbushetë ndë mbretërit të Perëndisë. ¹⁷ Edhe si mori, ufal ndersë, e tha, Merni këtë edhe nda-e-ni ndër mest t'ua. ¹⁸ Sepse po u them juve, se s'kam për të pirë prej pemës' së hardhisë, gjersa të vinjë mbretëri' e Perëndisë.

¹⁹ Pastaj mori bukë, e ufal ndersë, edh' e theu, e u'a dha atyre, dyke thënë, Ky është trupi im, që epetë për ju; këtë bëni për të përmëndurë mua. ²⁰ Kështu, passi udarkuanë **mori** edhe potirinë, dyke thënë, Ky potir është dhjata e-re ndë gjakt t'im, që derdhetë për ju, ²¹ Po na dor' e ati që më trathëton **tek** është bashkë me mua mbi trvezët. ²² Edhe i Bir' i njeriut vete sikundrë është urdhëruarë **për atë**, po mjer' ay njeri, me anë të të-cilit trathëtonetë. ²³ Edhe ata zunë të bishëtoninë ndër mest të tyre, se, vallë cili prej atyre dotë jet' ay që dotë bënë këtë.

²⁴ Ubë edhe një bishëtim ndër mest t'atyre, vallë cili prej atyre duketë, se është më i-math. ²⁵ Edhe ay u tha atyre, Mbretërit' e kombevet zotëronjënë mbi ata, edhe ata që kanë pushtet mbi ata quhenë mirëbërës. ²⁶ Po ju nukë dotë **jini kështu**; po më i-madhi ndër ju letë bënetë posi më i-vogëli, edhe ay që është i-parë posi ay që shërben. ²⁷ Sepse cili është më i-math, ay që ka ndënjurë ndë mësallët, apo ay që shërben? a jo ay që ka ndënjurë ndë mësallët? Po unë jam ndër mest t'ua posi ay që shërben. ²⁸ Edhe ju jini ata që keni qëndruarë bashkë me mua ndë ngasjet të mia. ²⁹ **Përandaj** edhe unë bënë gati për ju një mbretëri, sikundrë im Atë për mua, ³⁰ Që të hani e të pini mbë trvezët t'ime ndë mbretërit t'ime, edhe të rrini mbi frone, dyke gjykuarë të dy-mbë-dhjetët farat' e Israilit.

³¹ Edhe Zoti tha, Simon, Simon, na Satanaj tek u kërkoi juve, që t'u shohnjë posi grurëtë. ³² Po un' u luta për ty, që të mos të shteretë besa; edhe ti, kur të kthenesh, forco vëllezërit' e tu. ³³ Po ay i tha, Zot, jam gati të vete bashkë me ty edhe ndë burk edhe ndë vdekje. ³⁴ Po ay tha, Pjetër, po të them tyj, nukë dotë këndonjë sot këndesi, para se të më mohonjë tri herë, se nukë më njeh.

³⁵ Pastaj u tha atyre, kur u dërgova juve pa kuletë e pa trajshhtë e pa këpucë, mos u shteri gjë juve? Edhe ata thanë, Asgjë. ³⁶ U tha pra atyre, Po tashi ay që të ketë kuletë, le t'a marrë **me vetëhe**; kështu edhe trajshhtë; edhe ay që të mos ketë, le të shesë rrobën' e ti, edhe letë blierë thikë. ³⁷ Sepse po u them juve, se edhe këjo e-shkruarë duhetë të mbushetë mbë mua, se, "Edhe me të-pauidhëtë unumërua;" sepse të shkruaratë për mua po marrënë funt. ³⁸ Edhe ata thanë, Zot, na tek **janë** këtu dy thikë. Edhe ay u tha atyre, Mjaft është.

³⁹ Pastaj doli e vate, sikundrë e kishte zakon ndë malt të Ullinjet; edhe i vanë pas edhe nxënësit' e ti. ⁴⁰ Edhe si erdhi ndë vëntt, u tha atyre, Fali për të mos hyrë ndë ngasje.

⁴¹ Edhe ay unda nga ata sa një të-hedhurë guri, edhe ra mbë gjunjë e falej, ⁴² Dyke thënë, O Atë, ndë daç të largonjë këtë potir prej meje; përveç jo dashurimi im, po yti le të bënetë. ⁴³ Edhe i uduk **një** ëngjëll prej qielli dyke dhënë fuqi ati.

⁴⁴ Edhe si erdhi ndë shtrëngim shpirti falej më tepërë. Edhe djersa e ati ubë posi të-ngriira pika gjaku dyke rënë mbi dhet.

⁴⁵ Edhe si ungrit nga të-faluritë, erdhi te nxënësit' e ti, e i gjeti dyke fjeturë nga hidhë-rimi, ⁴⁶ E u tha atyre, Ç'flini? ngreuni e fali, që të mos hyni ndë ngasje.

⁴⁷ Edhe ay tek po fliste, na gjindja, edhe ay që thuhej Judhë, një nga të dy-mbë-dhjetëtë, tek po vinte përpara atyreve, edhe uafërua te Jisuj, që t'e puthte.

⁴⁸ Edhe Jisuj i tha, Judhë, me të-puthurë thathëton të Birin' e njeriut?

⁴⁹ Edhe ata **që ishinë** rreth ati kur panë, se ç'dotë bënej, i thanë, Zot, t'u bjemë me thikë? ⁵⁰ Edhe një nga ata i ra shërbëtorit të kryepriiftit, edhe i preu veshn' e djathtë. ⁵¹ Po Jisuj upërgjeq e tha, Ler-e-ni gjer këtu; edhe zuri veshn' e ati, edhe e shëroj.

⁵² Edhe Jisuj u tha kryepriiftëret e të-parëvet të hieroresë e pleqet që kishinë ardhurë mbi atë, Posi mbi kursar keni dalë me thikë e me dru? ⁵³ Unë përdita jeshe me ju ndë hieroret, edhe nukë shtritë duartë mbi mua. Po këjo është ora juaj, edhe pushteti i errësirësë.

⁵⁴ Edhe si e zunë, e shpunë, edhe e prunë ndë shtëpit të kryepriiftit. Edhe Pjetri i vinte pas për së-largu.

⁵⁵ Edhe ata si ndezë zjarr ndë mest të hoborit, edhe ndënjë bashkë, rrinte **edhe** Pjetri ndë mest t'atyreve. ⁵⁶ Edhe një shërbëtore, kur e pa atë dyke ndënjurë drejt dritësë, e dyke shtyrë sytë mb'atë tha, Edhe ky ishte bashkë me atë. ⁵⁷ Po ay e mohoj, dyke thënë, O grua, nuk' e njoh. ⁵⁸ Edhe pas pakëzë e pa atë një tjetërë, edhe tha, Edhe ti je prej atyreve. Po Pjetri tha, O njeri, nukë jam. ⁵⁹ Edhe passi shkoj si ndonjë orë, një tjetërë qëndronte me fuqi, dyke thënë, Me të-vërtetë edhe ky ishte bashkë me atë; sepse edhe Galileas është. ⁶⁰ Po Pjetri tha, O njeri, nukë di ç'thua. Edhe për-një-here, tek ishte ay edhe dyke folurë, këndoj këndesi. ⁶¹ Edhe Zoti ukthye e shtyri sytë mbi Pjetrinë; edhe Pjetrit i ra ndër mënt fjal' e Zotit që i pat thënë se, para se të këndonjë këndesi, dotë më mohonjë tri herë. ⁶² Edhe Pjetri doli jashtë, edhe qau hidhurë.

⁶³ Edhe ata burrat që mbaninë Jisunë e përqeshninë edhe e rrihninë; ⁶⁴ Edhe dyke mbuluarë syt' e ati i bininë faqesë edhe e pyetninë, dyke thënë, Profiteps, cili është ay që të ra? ⁶⁵ Edhe i thoshninë shumë të-tjera dyke sharë.

⁶⁶ Edhe si ubë ditë, umbloth pleqësi' e llauzit e kryepriiftërit' e shkronjësitë, edhe e prunë lart ndë bashkëndënjët të tyre, dyke thënë, Ndë je ti Krishti, thua-na. ⁶⁷ Edhe

ay u tha atyre, Ndë u thënça juve, nukë dotë besoni; ⁶⁸ Edhe ndë u pyeça, nukë dotë më përgjigji, as nukë dotë **më** lëshoni. ⁶⁹ Që tashi i Bir' i njeriut dotë jetë dyke ndënjurë prej së djathtës' së fuqis' së Perëndisë. ⁷⁰ Atëhere të-gjithë thanë, Ti pra je i Bir' i Perëndisë? Edhe ay u tha atyre, Ju po thoni se unë jam. ⁷¹ Edhe ata thanë, Ç'nevojë kemi më për dëshmim, sepse **neve** vetë e dëgjuamë prej gojës' s'ati.

Krye 23

¹ Atëhere gjithë shumica e atyreve ungritnë, edhe e prunë te Pillati.

² Edhe zunë t'e përlisninë, dyke thënë, se këtë e gjetmë dyke prishurë kombinë, edhe dyke ndaluarë **njerëzitë** t'i apënë pagesa Qesarit, dyke thënë për vetëhen' e ti se është Krishti mbreti. ³ Edhe Pillati e pyeti, dyke thënë, Ti je mbreti i Judhenjet? Edhe ay upërgjeq e i tha, Ti po thua.

⁴ Edhe Pillati u tha kryepriiftërvet edhe gjindjesë, Asndonjë faj nukë gjenj te ky njeri. ⁵ Po qëndroninë me fuqi dyke thënë, Se trazon llauzinë, dyke mësuarë ndëpër gjithë Judhenë, dyke zënë që nga Galilea e gjer këtu. ⁶ Edhe Pillati kur dëgjoj **fjalënë** Galilea, pyeti, ndë është njeriu Galileas. ⁷ Edhe kur e mori vesh, se ishte prej **vëndit të** pushtetit të Irodhit, e dërgoj te Irodhi, i-cili edhe ay ato dit ishte ndë Jerusolim.

⁸ Edhe Irodhi kur pa Jisunë, ugëzua shumë; se kish mjaft kohë që doj t'a shihte, sepse kishte dëgjuarë shumë **gjërra** për atë; edhe shprente të shihte ndonjë shënjë të bënej prej ati. ⁹ Edhe e pyeste me shumë fjalë; po ay nuk' i përgjigjej asgjë. ¹⁰ Edhe kryepriiftërit' e shkronjësitë rrininë dyke përfolur' atë me nxehtësirë të-madhe. ¹¹ Edhe Irodhi bashkë me ushtëtarët' e ti e bëri për asgjë, edhe e përqeshi, edhe i veshi një rrobë të-ndriçime, edhe e dërgoj përsëri te Pillati. ¹² Edhe nd'atë ditë Pillati edhe Irodhi u bënë miq njeri me tjetrinë; sepse më përpara ishinë nd'armiqësi njeri me tjetrinë.

¹³ Edhe Pillati si thirri bashkë kryepriiftërit edhe të-parët' edhe llauzinë, ¹⁴ U tha atyre, Prutë këtë njeri tek unë, se sikur trazon llauzë; edhe na unë përpara jush e pyeta hollë hollë, edhe nukë gjeta ndonjë faj te ky njeri nga sa të-përfolura thoni kundr' ati; ¹⁵ Po as Irodhi; sepse u dërgova juve tek ay; edhe na asgjë të-vëjjeturë për vdekje s'ka bërë. ¹⁶ Passi t'a mundonj pra, dot'e lëshonj.

¹⁷ Edhe prej nevoje duhej t'u lëshonte atyre një **nga të-burgosuritë** për të-kremte. ¹⁸ Po të-gjithë bashkë bëritnë, dyke thënë, Ngrej-e këtë, edhe na lësho Varavvanë, ¹⁹ I-cili ishte hedhurë ndë burk për një trazirë që ishte bërë ndë qytett, edhe për vrasje.

²⁰ Përsëri pra Pillati u foli **atyre**, sepse donte t'a lëshonte Jisunë. ²¹ Po ata thërritininë, dyke thënë, Kryqëzo-e, kryqëzo-e. ²² Edhe ay për të-tretënë herë utha atyre, Përse, ç'të keqe ka bërë? asndonjë faj për vdekje s'gjeta tek ay; passi t'e mundonj pra, dot' e lëshonj. ²³ Po ata qëndroninë me zë të-math, dyke kërkuarë të kryqëzonetë; edhe zëret' e atyre e të kryepriiftëret po forconeshinë shum' e më shumë. ²⁴ Edhe Pillati vendosi të bënetë kërkimi i atyre. ²⁵ Edhe u lëshoj atyre atë që ishte hedhurë ndë burkt për trazirë e për vrasje, të-cilinë e kërkoninë, po Jisun' e dha ndë dashurimt t'atyre.

²⁶ Edhe si e nxuarnë jashtë, zunë një farë Simon Qirineas, që ishte dyke ardhurë nga ara, edhe i vunë kryqnë mbë krahë, që t'e sillte prapa Jisujt.

²⁷ Edhe i vininë prapa shumë shumicë llauzi, e grash, të-cilatë edhe çireshin' e ulërininë për atë. ²⁸ Po Jisuj u kthye e u tha atyre, Bija të Jerusalemit, mos qani për mua, po qani për vetëhenë t'uaj edhe për fëmijënë t'uaj. ²⁹ Sepse na tek po vinjënë dit, ndë të-cilat dotë thonë, Lum beronjatë, edhe ata barke që nukë puallë, edhe ata gjij që nukë dhanë sisë. ³⁰ Atëhere dotë zënë t'u thonë malevet, Bini mbi ne;

edhe kodravet, Mbulo-na-ni. ³¹ Sepse ndë mbë drun' e njomë bënjenë këto, mbë të-thatënë ç'dotë bënetë?

³² Po silleshinë edhe dy të-tjerë keq-bërës që të vriteshinë bashkë me atë.

³³ Edhe kur erdhë ndë vëntt që quhetë **vënd'** i Kresë, atje kryqëzuan' atë, edhe keq-bërësitë, njërinë mbë të-djathtë, edhe tjarinë mbë të-mëngjërë. ³⁴ Edhe Jisuj thoshte, O Atë, ndje-i ata; sepse nukë dinë se ç'bënjënë.

Edhe llaqe ndarë rrobat e ati, shtynë shortë.

³⁵ Edhe llauzi rrij e po vështronte. Edhe të-parët' e përqeshninë bashkë me ata, dyke thënë, Të-tjerë shpëtoj; letë shpëtonjë vetëhen' e ti, ndë është ky Krishti, i-sgjedhuri i Perëndisë. ³⁶ Edhe e përqeshnin' atë edhe ushtëtarëtë, dyke afruarë e dyke dhënë atij uthullë, ³⁷ Edhe dyke thënë, Ndë je ti mbreti i Judhenjet, shpëto vetëhenë t'ënde.

³⁸ Edhe ishte shkruarë mbi atë edhe një për-mbishkronjë me shkronja Gërquishte e Llatinishte e Ebraishte, *Ky është mbreti i Judhenjet*.

³⁹ Edhe një nga ata keq-bërësitë që ishinë varurë e shante atë, dyke thënë, Ndë je ti Krishti, shpëto vetëhenë t'ënde edhe neve. ⁴⁰ Po tjtatëri upërgjeq, edh' e qërtoj atë, dyke thënë, As nga Perëndia s'ke frikë ti, i-cili je ndë një dënim me atë? ⁴¹ Edhe neve me të-drejtë **jemi dënuarë**, sepse marrmë çpagim sikundrë na vjen për sa punuamë; po ky asndonjë të-keqe nukë bëri. ⁴² Pastaj i thoshte Krishtit, Kujto-më, o Zot, kur të vish ndë mbretërit t'ënde. ⁴³ Edhe Jisuj i tha, Me të-vërtetë po të them, sot dotë jesh bashkë me mua ndë paradhist.

⁴⁴ Edhe ora ishte sindonja gjashtë, edhe ubë errësirë mbë gjithë dhenë gjer mbë të-nëntënë orë. ⁴⁵ Edhe djelli uerr; edhe kurtina e tempullit uça për mesi.

⁴⁶ Edhe Jisuj thirri me zë të-math, e tha, O Atë, ndë duart të tua ap shpirtinë t'im. Edhe si tha këto, dha shpirtinë.

⁴⁷ Edhe krye-qindësi, kur pa se ç'ubë, lavduroj Perëndinë, dyke thënë, Me të-vërtetë ky njeri paskërka qënë i-drejtë.

⁴⁸ Edhe gjithë gjindja që kishin' ardhurë bashkë për të vënë re, kur panë se ç'ubë, ktheheshinë dyke rrahurë krahërorët' e tyre. ⁴⁹ Edhe rrininë gjithë të-njohurit' e ti për së-largu, **si** edhe gratë që kishin' ardhurë bashkë me atë nga Galilea, dyke shikuarë këto **punë**.

⁵⁰ Edhe navoka një burrë që quhej Josif, i-cili ishte an' e këshillësë, njeri i-mir' e i-drejtë, ⁵¹ (Ky nukë pat qënë ndë një mëndje ndë këshillët e ndë punët t'atyre;) nga Arimathea, **një** qytet i Judhenjet, i-cili edhe vetë priste mbretërin' e Perëndisë. ⁵² Ky erdhi përënë Pillatit, edhe lypi trupin' e Jisujt. ⁵³ Edhe si e sbriti, e pshtolli me pëlhurë, edhe e vuri ndë një varr të-gdhëndurë ndë gur, ku asndonjë kurrë s'ishte vënë. ⁵⁴ Edhe ishte dit' e-prëmtë, edhe gdhiehej e-shëtunë.

⁵⁵ Edhe i vanë prapa edhe gra, të-cilatë kishin' ardhurë bashkë me atë nga Galilea, e panë varrinë, edhe se si uvu trup' i ati' **atje**. ⁵⁶ Edhe ukthyen' e bënë gati erëra të-mira e vajra ere; edhe të-shëtunën' uprëjtnë pas porosis' **së nomit**.

Krye 24

¹ Edhe ditën' e-parë të javësë, fort që me natë, erthnë mbi varrt, e prunë ato erërat' e-mira, të-cilatë kishinë bërë gati; **ishinë** edhe ca veta bashkë me ato.

² Edhe gjetnë gurrë të-rrukullisurë prej varrit. ³ Edhe si hynë brënda, nuk' e gjetnë trupin' e Zotit Jisu. ⁴ Edhe këto tek po vrisninë mëndjenë për këtë punë, na tek qëndruanë përpara atyre dy burra me roba që vetëtininë. ⁵ Edhe me-qënë-që ato ufrikësuanë, edhe ulnë faqenë mbë dhet, **ata** u than' atyre, Ç'kërkoni të-gjallinë ndër të-vdekurit? ⁶ Nuk' është këtu, po ungjall. Kujtohi, si u pat folë juve, kur qe edhe ndë Galilet, ⁷ Dyke thënë, Se duhetë i Bir' i njeriut të epetë ndër duar

njerëzish fajtorë, edhe të kryqëzonetë, edhe të-tretënë ditë të ngja-lletë. ⁸ Edhe u ranë ndër mëntt atyre fjalët' e ati.

⁹ Edhe si ukthyenë nga varri, u dhanë zë për gjithë këto të një-mbë-dhjetët edhe gjithë të-tjerëvet. ¹⁰ Edhe ishinë Maria Magdhalinë, edhe Joana, edhe Maria e ëm'e Jakovit, edhe të tjeratë bashkë me ato, të cilatë u thoshin' apostojvet këto **fjalë**.

¹¹ Po fjalët' e atyreve u-duk në përpara atyreve posi fjalë të-sbrazëta, edhe nuk' u zininë besë atyre.

¹² Edhe Pjetri ungrit e vate me vrap ndë varrt; edhe uunj e pa pëlhuratë që ishinë përdhe vetëmë; Edhe iku dyke çuditurë me vetëhen' e ti për këtë punë.

¹³ Edhe dy veta prej atyreve tek ishinë dyke vaturë atë ditë ndë një fshat që quhej Emmaus, që ishte gjashtë-dhjetë stadhe lark nga Jerusalmi. ¹⁴ Edhe ata flisninë ndër mest të-tyre për gjithë këto që kishinë ngjarë. ¹⁵ Edhe kur po flisnin' e haeshinë njëri me tjetrinë uafërua edhe vetë Jisuj, e ecënte bashkë me ata. ¹⁶ Po syt' e atyre mbaheshinë për të mos njohur' atë.

¹⁷ Edhe **ay** u tha atyre, **Ç'janë** këto fjalë që flitni njëri me tjetrinë dyke ecurë, edhe përse jini të vrërëtë? ¹⁸ Edhe njëri, që e kishte emërinë Kleopë, upërgjeq e tha, Vetëmë ti qënke i huaj ndë Jerusalm, edhe s'paske marrë vesh se ç'janë bërë nd'atë ndër këto ditë? ¹⁹ Edhe ay u tha atyre, Cilatë? Edhe ata i thanë, Punët' e Jisu Nazoreasit, i-cili qe njeri profit, i fortë ndë punë e ndë fjalë përpara Perëndisë edhe gjithë lauazit; ²⁰ edhe si kryepfitërit' edhe të-parëtë t'anë e dhanë ndër duar për dënim vdekjeje, edhe e kryqëzuanë. ²¹ Edhe neve shprenimë, se ay ishte që kishte për të çpërblyerë Israilinë. Po mbi gjithë këto, sot është' e treta ditë që kur se ubënë këto; ²² Po edhe ca gra prej nesh na habitnë, të cilatë vanë çpejt që me natë ndë varrt; ²³ Edhe passi nukë gjetnë trupin' e ati, erthnë dyke thënë, se kishinë parë edhe një të-dukur' ëngjëjsh, të-cilëtë thanë, se ay rron. ²⁴ Edhe ca nga t'anëtë vanë ndë varrt, edhe gjetnë kështu, sikundrë than' edhe gratë; po atë nuk e panë. ²⁵ Atëhere ay u tha atyre, O të marrë edhe të-mënuarë ndë zëmëret për të-besuarë gjith'ato që folnë profitëritë. ²⁶ Nukë duhej të pësonte këto Krishti, edhe të hynte ndë lavdit të ti? ²⁷ Edhe dyke zënë që nga Moisiu edhe që nga gjithë profitëritë, u sgithte atyre ato **që ishinë shkruarë** për atë ndëpër gjithë shkronjat.

²⁸ Edhe uafërua ndë fshatt, që po vininë; Edhe ay ubë sikur kishte për të vaturë më tej. ²⁹ Po ata e shtrënguanë tepërë, dyke thënë, Mbetu bashkë me ne, sepse është ndaj të-ngrysurë, edhe dita uthye. Edhe ay hyri për të mbeturë bashkë me ata. ³⁰ Edhe si ndënji ndë mësallët bashkë me ata, mori bukënë, e bekoj, edhe e theu, edhe u'a ndau atyre. ³¹ Atëhere uhapnë syt' e atyre, edhe e njohnë; po ay humbi prej sysh t'atyre. ³² Edhe ata i thanë njëri tjetrit, Nukë digjej zëmëra jonë ndër ne, kur na fliste udhësë edhe na sgithte shkronjatë.

³³ Edhe ungritnë nd'atë orë, edhe ukthyenë ndë Jerusalm, edhe gjetnë mbledhurë bashkë të dy-mbë-dhjetëtë, edhe ata që ishinë bashkë me ata,

³⁴ Të-cilëtë thoshinë, Se me të-vërtetë Zoti ungjall, edhe uduk te Simoni. ³⁵ Edhe ata **prapë** dëfteninë **ç'punë u** ngjanë udhësë, edhe si unjoh tek ata ndë të-thyerët të bukësë.

³⁶ Edhe tek ata po flisninë këto, vetë Jisuj qëndroj ndë mest t'atyreve, edhe u thotë, Paqtim mbë ju. ³⁷ Po ata utrëpnë e ufrikësuane, sepse u dukej, se po shihninë **ndonjë** frymë. ³⁸ Edhe ay u tha atyre, Përse jini të-trumbulluarë? edhe përse hipnjënë ndë zëmërat t'uaj mendime? ³⁹ Shihni duart' e mia edhe këmbët' e mia, se unë jam ay; zë-më-ni edhe shihni; se fryma s'ka mish e eshtëra, sikundrë shihni mua se kam. ⁴⁰ Edhe si tha këtë, u dëftu duart' edhe këmbëtë. ⁴¹ Po tek nukë besoninë ata nga gëzimi edhe çuditëshinë, u tha atyre, A kini gjë për të ngrënë këtu? ⁴² Edhe ata i dhanë një copë peshku të-pjekurë edhe hoj mjalte.

⁴³ Edhe ay mori e hëngri përpara atyreve.

⁴⁴ Pastaj u tha atyre, Këto **jan' ato** fjalë, që u folën juve, kur ishin bashkë me ju, se duhet të mbushenë gjith'ato që janë shkruarë në librat e Moisiut edhe në Psallmet për mua. ⁴⁵ Atëherë u hapi mendjen' atyre, që të merrninë vesh shkronjatë. ⁴⁶ Edhe u tha atyre, Se kështu është shkruarë, edhe kështu duhet të hiqte Krishti, edhe të ngjallej prej së-vdekurish të-tretënë ditë, ⁴⁷ Edhe të lëçitej mb'emërit t'ati pendim edhe ndjesë fajesh mbë gjithë kombet, dyke zënë nga Jerusalmi. ⁴⁸ Edhe ju jeni dëshmitarë për këto. ⁴⁹ Edhe na unë tek po dërgonj të-zotuarat' e t'im Et mbi ju; edhe ju rrini në qytet Jerusalm, gjersa të vishi me fuqi prej së-larti.

⁵⁰ Pastaj i nxori jashtë gjer në Vithani; edhe ngriti duart' e tia e i bekoj. ⁵¹ Edhe ay dyke bekuar' ata unda nga ata, edhe birej lart në qiell. ⁵² Edhe ata si i ufal në ati, ukthyenë në Jerusalm me gëzim të-math. ⁵³ Edhe ishinë gjithënjë në hieroret, dyke lavdruarë e dyke bekuarë Perëndinë. Amin.